



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**FAKULTETI JURIDIK**

**PROGRAMI-E DREJTA CIVILE**

**STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË**

**TEZA: “Pikat e lidhjes si pjesë e normës së kolizionit-  
Vendbanimi dhe Shtetësia”**

Kandidati:

Illzana Elmazi

Mentor :

Prof.Dr. Bekim Nuhija

Mars, 2021

## Abstrakt

Temën të cilën e kam përzgjedhur që të trajtoj i takon fushës civile dhe trajtohet pikërisht “Pika e lidhjes si pjesë thelbësore e normes së kolizionit”- Venbanimi dhe shtetësia. Në suaza të këtij punimi do të rishikohet edhe literatura që ka studiuar dhe studion këtë pjesë. Fillimisht në këtë temë do të trajtohen njohuri të përgjithshme mbi të Pikat e lidhjes si pjesë thelbësore e normes së kolizionit dhe vendbanimi. Nocioni “Pikat e lidhjes si pjesë thelbësore e normes së kolizionit dhe vendbanimit” është një nocion shumë i diskutueshëm dhe nevojitet të sqarohet, domethënia e saj juridike. Nocioni i vendbanimit paraqet lidhjen juridike të qytetarit me vendin. Qytetarët të cilët gëzojnë të drejta dhe detyrime (lojalitetin, gëzimin e të drejtave politike, ushtrimi i shërbimit ushtarak, gëzimi i mbrojtjes shtetërore për qytetaret jashtë shtetit, mbrojtjen e vendit, të drejtën e ekstradimit etj.) dhe i nënshtrohen jurisdiksionit shtetëror quhen vendas. Qytetarët të cilët gëzojnë të drejta private-civile dhe gëzojnë imunitetin personal, jo edhe autorizime dhe obligime të tjera janë qytetarë jo vendas. Vendqendrimi mund të fitohet në mënyra të ndryshme: a) Kur prindërit (paraardhësit) kanë lindur në atë shtet (jus sanguinis), b) Kur lind në atë territor të atij shteti (jus soli), c) Martesa me një shtetas të atij vendi (jure matrimonii) dhe d) Natyralizmi, ku individë të cilët nuk kanë lidhje me atë shtet mund të fitojnë shtetësi nëse qëndrojnë për kohë të caktuar në atë shtet dhe i nënshtrohen disa testeve përkatëse. Humbja e shtetësisë mund të bëhet sipas kushteve që i parasheh ligji, siç është largimi apo mohimi i shtetësisë dhe marrja e saj, si dhe kur territori i një shteti kalon në territorin e shtetit tjetër, gjegjësisht, bëhet territor i shtetit tjetër. Poashtu në tezën timë të masterit do të shikojmë edhe këndvështrimin juridik të shtetësisë dhe këtu mund të përkufizojmë se shtetësia është një përkatësi juridike e një personi në popullsinë e një shteti.

## Апстракт

Темата што ја одбрав припаѓа на граѓанското поле и е адресирана токму „Точката на поврзување како суштински дел од стапката на судир“ –Престој и државјанство. Во рамките на овој труд, ќе се разгледа литературата што го проучуваше и го проучува овој дел. Првично во оваа тема ќе се третираат општите сознанија за тоа Точките на поврзување како суштински дел од стапката на судир и порамнувањето. Поимот „Точки на поврзување како суштински дел од стапката на судир и порамнување“ е многу контроверзен поим и треба да се разјасни неговото правно значење. Поимот престој претставува правна врска на граѓанинот со местото. Граѓаните кои уживаат права и обврски (лојалност, уживање во политички права, вршење на воена служба, уживање во заштита на државата за граѓаните во странство, одбрана на земјата, право на екстрадиција и слично) и се предмет на државна јурисдикција се нарекуваат локални жители. Граѓаните кои уживаат приватно-граѓански права и уживаат личен имунитет, а не други овластувања и обврски се невородени граѓани. Живеалиштето може да се стекне на различни начини: а) Кога родителите (предците) се родени во таа држава (*jus sanguinis*), б) Кога тој е роден на таа територија на таа држава (*jus soli*), в) Брак со државјанин на таа земја (*jure matrimonii*) и г) натурализам, каде што поединци кои не се поврзани со таа држава можат да стекнат државјанство ако останат одреден временски период во таа држава и подлежат на некои релевантни тестови. Губење на државјанството може да се изврши според условите предвидени со закон, како што се отстранување или одбивање на државјанство и нејзино стекнување, како и кога територијата на една држава преминува на територијата на друга држава, т.е. станува територија на друга држава. Исто така, во мојата магистерска теза ќе ја разгледаме правната перспектива на државјанството и тука можеме да дефинираме дека државјанството е правна припадност на некоја личност во популацијата на една држава.

## Abstract

The topic that I have chosen to address belongs to the civil field and is addressed exactly "The point of connection as an essential part of the collision rate" – Residence and citizenship. In the framework of this paper, the literature that has studied and is studying this part will be reviewed. Initially in this topic will be treated general knowledge on it Points of connection as an essential part of the collision rate and settlement. The notion "Points of connection as an essential part of the collision rate and settlement" is a very controversial notion and needs to be clarified, its legal meaning. The notion of residence represents the legal connection of the citizen with the place. Citizens who enjoy rights and obligations (loyalty, enjoyment of political rights, exercise of military service, enjoyment of state protection for citizens abroad, defense of the country, right to extradition, etc.) and are subject to state jurisdiction are called natives. Citizens who enjoy private-civil rights and enjoy personal immunity, not other authorizations and obligations are non-native citizens. Residence can be acquired in different ways: a) When the parents (ancestors) were born in that state (jus sanguinis), b) When he was born in that territory of that state (jus soli), c) Marriage to a citizen of that country (jure matrimonii) and d) Naturalism, where individuals who are not affiliated with that state can acquire citizenship if they stay for a certain period of time in that state and undergo some relevant tests. Loss of citizenship can be done according to the conditions provided by law, such as the removal or denial of citizenship and its acquisition, as well as when the territory of one state passes into the territory of another state, ie, becomes the territory of another state. Also in my master thesis I will look at the legal perspective of citizenship and here we can define that citizenship is a legal affiliation of a person in the population of a state.

# Përmbajtje

1. LËNDA E HULUMTIMIT .....	7
2.Qëllimet e hulumtimit.....	9
3.Hipotezat.....	100
Hiploteza kryesore: .....	100
Hipoteza ndihmëse: .....	100
4. RËNDËSIA E PUNIMIT .....	111
5.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....	111
6. PËRZGJEDHJA E MOSTRËS.....	122
7. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT E PUNIMIT .....	122
HYRJE.....	133
KAPITULLI I .....	144
1. Vendbanimi.....	144
1.1 Parimet themelore të vendbanimit .....	144
1.2 Faktet e identifikimit në subjekt të mardhenjeve juridiko-private me element të huaj .....	15
1.3 Faktet e identifikimit ne subjekt të marrëdhënieve juridiko-private me element te huaj.....	155
1.4 Faktet e identifikimit të objektit të marrëdhënies juridiko-private.....	155
1.5 Parimet themelore të vendbanimit .....	166
2. KAPITULLI II .....	17
2. Kuptimi dhe llojet e vendbanimit si fakt i identifikimit.....	17
2.1 Vendbanimi (domicili) si fakt identifikimi .....	17
2.1 Vendbanimi si fakt vendimtar dhe si fakt subsidiar.....	19
2.2.1 Vendi i lidhjes së kontratës si fakt vendimtarë për rregullimin e përmbajtjes së kontratës.....	19
2.2.2 Vendi i përmbushjes së kontratës si fakt vendimtar për rregullimin e përmbajtjes së kontratës	20
2.2.3 Vendbanimi ose selia e debitorit të detyrimit karakteristike si fakt vendimtar .....	20
KAPITULLI III .....	27
3. Faktet e vendimtare (Pikat e lidhjes) .....	277
3.1 Shmangiet nga normat kompetente të së drejtës ndërkombetare private, korrektimi i kolizioneve .....	27
3.2 Vendbanimi si fakt vendimtar primar, roli i tij.....	27

3.1.1	Vendbanimi si fakt vendimtar .....	28
3.2.2	Vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar .....	28
3.2.3	Vendqëndrimi i rregullt dhe vendqëndrim i pa rregullt.....	28
3.2.4	Vendbanimi si fakt identifikimi tek personat me element të huaj juridiko privat.....	30
3.2.5	Faktet vendimtare për rregullimin e përmbajtjes së mardhënieve kontraktuese me element të huaj .....	31
KAPITULLI IV .....		<b>Error! Bookmark not defined.</b> 3
4	.Shtetësia si pikë e lidhjes –Efektet e shtetësisë.....	333
4.1	Burimet e të drejtës së shtetësisë.....	366
4.2	Liria e shteteve.....	37
4.3	Konfliktet e shtetësisë.....	37
4.4	Personat me disa shtetësi .....	410
4.5	Evidenca e shtetasve dhe lëshimi i certifikates të shtetësisë .....	444
4.6	Shtetësia si fakt vendimtarë (në mardhëniet statusore) .....	455
4.7	Shtetësia si fakt vendimtarë (në mardhëniet trashëgimore).....	47
KAPITULLI V .....		522
5	Humbja e shtetësisë.....	522
5.1	Humbja e shtetësisë për shkak të shprehjes së vullnetit - dëshirës .....	533
Rezultatet e hulumtimit – Analizat e fitimit të vendbanimit nëper vende të ndryshme në rajon .....		555
Konkluzioni.....		577
Rekomandime .....		58
Përfundimi .....		59
BIBLIOGRAFIA.....		600

## 1. LËNDA E HULUMTIMIT

Lënda e hulumtimit është përfshirë në disa pika kyçe si në vijim:

Fillimisht në këtë temë do të trajtohen njohurit mbi vendbanimin(domicili) njëlloj sikurse edhe shketësia ku paraqitet si fakt identifikimi ( fakt në bazë të cilit konstatohet pranija e elementit të huaj ) në bazë të cilit konstatohet elementi i huaj juridiko privat në subjekt .

Vendbanimi ka eksistuar që ne Romën skllavopronare ,ku kanë ekzistuar tre lloje të vendbanimit:domiciliom voluntarium,domicilium necesarium dhe domicium derivatum.

Në te Drejtën ndërkombetare privat ,ekzistojnë dy lloje të vendbanimit: vendbanim me dëshirë(domicium voluntarium) dhe vendbanim ligjor (domicilum voluntarium).Vendbanimi me dëshirë(domivilum voluntarium) krijohet kur një person përgjithmonë vendoset në ate shtet me qëllim që aty përgjithmonë të banoj, ndërsa vendbanimi ligjor(domicilium necesarium) është ajo qendër e marrënjeve jetësore që me ligj i caktohet kategorisë së caktuar të personave në një shtet për të mbrojtur interesat e tyre si dhe interesat e rrethit ku ata jetojnë.

Ndërsa vendbanimi si fakt identifikimi (fakt në bazë të cilit krijohet elementi i huaj) juridiko privat, gjithashtu paraqitet edhe si fakt vendimtar(pikë e lidhjes),në bazë të cilit përcaktohet zbatimi i së drejtës të shtetit të vendit ose të huaj tek marrëdhëniet statusore dhe trashëgimore me element të huaj ,edhe atë ,krejtesisht tek shtetet e imigracionit. Vendbanimi si fakt vendimtar përbehet nga këto kategori:

Vendbanimi si fakt vendimtar primar, vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar,vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar për gëzimin e të drejtave konkrete civile nga të huajt, vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar për caktimin e të drejtës kompetente (të vendit ose të huaj ),vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar për caktimin e kompetencës së gjykatës të vendit të huaj dhe vendqendrimi i rregulltë

Përveç që vendbanimi shfaqet si fakt identifikimi (fakt në bazë të cilit krijohet elementi i huaj) jurikiko privat,gjithashtu paraqitet edhe si fakt vendimtar ne bazë të cilit ku përcaktohet edhe kompetenca e gjykatës Po ashtu në temën timë të masterit do të shikojmë edhe këndvështrimin

juridik të vendbanimit si fakt identifikimi dhe fakt vendimtar dhe këtu mund të përkufizojmë se vendbanimi është i perber me dy elemente të cilat janë elementi fakt dhe elementi i vullnetit .

Faktorë sociologjik në dhëniën e vendbanimit është edhe një pikë shumë e rëndësishme. Faktorët sociologjik luajnë një rol shumë të madhë në të dyjat kolonat që përcaktojnë vendbanimin si fakt identifikimi dhe fakt vendimtar. Vendbanimi si nocion juridik ekziston edhe përdoret edhe në të drejtën e brendshme ,edhe në të drejtën ndërkombetare private.

Ky qëndrim do të mbështetet me idenë që mënyra e jetesës dhe vlera e fëmijës influencohet domosdoshmërisht nga ata të prindit. Sistemi jus soli insiston në rëndësinë e vendit të lindjes dhe ose të qëndrimit.



## 2.Qëllimet e hulumtimit

Qëllimet kryesore të hulumtimit janë të rëndësishme, me anë të qëllimeve kuptojmë synimin çka duhet të arihet, çka dhe si realizohet ky fenomen në Maqedoni. Disa nga qëllimet e domosdoshme janë:

Vendbanimi është e lidhur ngushtë me vendin. Të qënurit vendas presupozon pjesëmarrjen aktive në jetën e një komuniteti politik, të një vend, duke gëzuar të drejta dhe detyra. Në demokraci çdo qytetar është mbajtës i një pjese të sovranitetit politik. Në kushtetutën e çdo vendi demokratik përcaktohen tre aspekte të vendbanimit:

Vendbanimi ligjor- shtetësia politike, e bazuar mbi pjesmarrjen politike (e drejta e votës, e drejta për tu zgjedhur, e drejta për të patur funksione publike dhe e drejta për të qënë i mbrojtur nga shteti kur je jashtë),- shtetësia sociale, rezultante e formimit të të drejtave socio-ekonomike (e drejta e shëndetit, e drejta e mbrojtjes kundër papunësisë, e drejta sindikale).Gjithashtu do të hartojmë në këtë punim edhe mënyrën e fitimit të shtetësisë edhe për dëshmimin e shtetësisë do të rishikojmë se si fitohet mënyra e shtetësisë.

### **3.Hipotezat**

#### **Hiploteza kryesore:**

Duke e ndërlidhur me temën:

- Vendbanimi është fakt vendimtarë në rastet ku vendasi i huaj duhet të gëzojë ndonjë të drejtë statusore.
- Vendbanimi si fakt identifikimi dhe fakt vendimtar.
- Vendbanimi si fakt identifikimi dhe si fakt vendimtar në caktimin e kompetencës së gjykatës së marrëdhënieve statusore.
- Roli i vendbanimit si fakt vendimtarë në marrëdhëniet trashigimore me element të huaj.

#### **Hipoteza ndihmëse:**

- Humbja me deklarim mund të ndodh për shkak të fitimit të vullnetshëm të vendbanimit të huaj ose për shkak të martesës me një të huaj.
- Humbja me dekret ndodh me kërkesën e të interesuarve.
- Humbja me vendim gjyqësor për humbjen e vendbanimit dënohet humbja e lidhjeve të një qytetari me Maqedoninë.

## **4. RËNDËSIA E PUNIMIT**

Punimi është i rëndësishëm së nëpërmjet literaturës vendase dhe asaj të huazuara të evidentoj domosdoshmërinë e sistemit të së drejtës së vendbanimit dhe rëndësisë së madhe të saj në një vendi. Njëkohësisht edhe faktorët që ndikojnë në procesin e marrjes së vendqendrimit. Punimi do të mundohet që të jep edhe faktorët ndikues në humbjen e vendbanimit. E ndjeva veten të obliguar që të hulumtoj në këtë çështje por edhe detyrën kryesore të këtij punimi se vendbanimi është një fakt shumë i rëndësishëm ku edhe në vend edhe në botë ti identifikohesh së cilit nacionalitet i takon.

## **5.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Ne jemi qytetarë dhe shpesh herë i marrim parasysh mirëqenien e të drejtave dhe detyrimeve që qytetaria vendos mbi anën tonë. Ky studim është bazuar në hulumtimin e rasteve të formulimit dhe fitimit të vendbanimit si pikë e lidhjes e normes së kolizionit.

Metodologjia e ndjekur për realizimin e këtij punimi është:

- Tek metoda diskriptive- kjo metodë më shërbej për marrjen e mendimeve dhe ideve nga autorë të ndryshëm të cilët kanë qasjen e tyre intelektuale në definimin dhe elaburimin e temës. Unë si hulumtues shkencor hulumtimet e mia do të bazoj në këto teori:
- Dhe metoda historike mua do të më shërbejë si një pasqyrë retrospektive të ndodhive dhe krizave të cilat e kanë përfshirë vendbanimin. Kronologjinë si ka qenë mënyra e fitimit të pikave të lidhjes si pjesë e nomen të kolizionit të vendbanimit dhe shtetësisë në periudha të ndryshme.
- Nga kjo pasqyrë mund të nxjerr fotografinë reale të situatave ku personat nuk kanë vendbanim apo mbajnë vendbanim të dyfishtë.

- Metoda e analizës me ndihmën e anketës e cila do të më shërbejë për të analizuar dhe për të kthjellur dokumentet, marrëveshjet, strategjitë, të cilët i kanë përdorur palët në fitimin e vendbanimit si pika e lidhjes së normës së koluzionit
- Metoda përshkruese me anë të kësaj metode paraqesim gjendjen dhe situatën reale në të cilën gjendet Republika e Maqedonisë Veriore me mos zbatimin e ligjit. Në këtë studim janë përdorur një sërë materialesh si libra të fushës, shkrime në artikuj shkencor.

## **6. PËRZGJEDHJA E MOSTRËS**

- Mostra është një grup i nxjerrë nga popullsia
- Mostra në punimin tim është vendbanimi dhe shtetësia si pikë e lidhjes si pjesë e normës së kolizionit të vendbanimit dhe shtetësisë

## **7. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT E PUNIMIT**

Synimi im kryesor ka qenë që të hartoj një tezë masteri me vlera sado të vogël por të qëndrueshëm në kohë, një punim i cili do të ketë vlera akademike siç janë afatet kohore dhe respektimi i standarteve të një punimi. Qëllimi i hartimit të këtij punimi ka qenë përmbushja e standardeve akademike me qëllim që të kalojë me sukses këtë sfidë të studimeve. Objektiva e punimit ka qenë që hollësisht të trajtohen të gjitha aspektet që nga nismat e para drejt hartimit të një punimi e deri në vlerësim të komisionit.

## HYRJE

Vendbanimi është një konstrukt ligjor që përshkruan marrëdhënien midis një individi dhe një lokaliteti ose vendi të caktuar. Vendbanimi (domicili) njëlloj sikurse edhe shtetësia paraqitet si fakt identifikimi (fakt në bazë të të cilit krijohet elementi i huaj) në bazë të të cilit konstatohet prezenca (prania) e elementit të huaj juridiko- privat në subjekt. Në të drejtën ndërkombëtare private vendbanimi (domicili) është qendër e mardhënieve jetësore të një personi në një shtet të caktuar, që do të thotë se për të DNP është me rëndësi se ku ndodhet ajo qendër respektivisht në cilin shtet, dhe nuk është me rëndësi se në cilin vend (qytet) në kuadër të atij shteti.

Ndërsa, shtetësia paraqet një prej pikave më të rëndësishme të lidhjes në të drejtën ndërkombëtare private. Nga kjo arsye, trajtimi i shtetësisë është i domosdoshëm te kjo degë e së drejtës paraqet lidhjen juridike ndërmjet një personi fizik dhe një shteti të caktuar sipas të cilës lidhje personi fizik i gezon të gjitha të drejtat politike, civile, ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejta tjera në shtetin shtetësinë e të cilit e ka .

## KAPITULLI I

### 1. Vendbanimi

Vendbanimi është një konstrukt ligjor që përshkruan marrëdhënien midis një individi dhe një lokaliteti ose vendi të caktuar. Ndonëse nuk ka një përkufizim uniform të domicilimit, sipas ligjeve të juridiksioneve më të zakonshme të ligjit, vendbanimi përbëhet nga dy elemente që duhet të ekzistojnë njëkohësisht:

- 1) *Praninë fizike në juridiksion dhe*
- 2) *qëllimin për të qëndruar pafundësisht*

Ky përkufizim i zakonshëm i ligjit ka qenë i kodifikuar në një formë apo tjetër në të dy ligjet federale dhe shtetërore. Për shembull, sipas ligjit të Nju Jorkut, "vendbanimi" përkufizohet si "një shtëpi, e përhershëm dhe kryesore në të cilën një person kudo që është vendosur përkohësisht gjithmonë synon të kthehet.

Një shembull i mirë është skema federale e patundshmërive dhe taksave të dhuruara nga SHBA ku Kodi i Shërbimit të brendshëm të të ardhurave miraton vendbanimin si bazë të tatimit, por Rregulloret e Thesarit tregojnë që termi vendbanim duhet të interpretohet si domicil.<sup>1</sup>(Lawrence & Rizzo, pp. 4, 5)

#### 1.1 Parimet themelore të vendbanimit

1. Asnjë person nuk mund të jetë pa vendbanim.
2. Asnjë person nuk mund njëkohësisht për të njëjtat qëllime të ketë më shumë se një vendbanim.

---

<sup>1</sup> Robert C. Lawrence, Elisa Shevlin Rizzo; Basic Conflict of Laws Principles, pg. 4, 5.  
[https://www.americanbar.org/content/dam/aba-cms\\_dotorg/products/inv/book/215399/Chapter%201.pdf](https://www.americanbar.org/content/dam/aba-cms_dotorg/products/inv/book/215399/Chapter%201.pdf)

3. Një vendbanim ekzistues prezumohet të vazhdojë derisa të vërtetohet se është fituar vendbanimi i ri.<sup>2</sup> (Singh, p. 2)

## 1.2 Faktet e identifikimit në subjekt të marrëdhënieve juridiko-private me element të huaj

Faktet e identifikimit në subjekt - janë fakte ose nocione me të cilat kuptohet se a është I shprehur elementi i huaj në Marrëdhënien juridiko private konkrete.<sup>3</sup>(Gashi, p. 5)Fakte në bazë të të cilave konstatohet prezenca e elementit të huaj në subjekt te marrëdhënies juridiko-private me element të huaj për persona fizik janë shtetësia dhe vendbanimi, kurse përkatësia (nacionaliteti) për personat juridik.

## 1.3 Faktet e identifikimit në subjekt të marrëdhënieve juridiko-private me element të huaj

Si fakte ne baze te te cilave konstatohet prezenca e elementeve te huaj ne një subjekt janë:

- a) Shtetësia dhe Vendbanimi (domicili) për persona fizike.
- b) Nacionaliteti për persona juridik.<sup>4</sup>

## 1.4 Faktet e identifikimit të objektit të marrëdhënies juridiko-private

---

<sup>2</sup>Avinash Singh; Concept of domicile under private international law, pg.2

[http://www.supremecourtcases.com/index2.php?option=com\\_content&itemid=1&do\\_pdf=1&id=20970](http://www.supremecourtcases.com/index2.php?option=com_content&itemid=1&do_pdf=1&id=20970)

<sup>3</sup>Yllka Gashi; E Drejta Ndërkombëtare Private, Academia, pg, 5

[http://www.academia.edu/36102042/E\\_Drejta\\_Nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare\\_Private](http://www.academia.edu/36102042/E_Drejta_Nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare_Private)

<sup>4</sup> Rino Duraku; E drejta ndërkombëtare private pjesa 1 dhe 2.pdf, SCRIBD, fq, 11  
<https://ëëë.scribd.com/doc/112554351/E-drejta-nderkombetare-private-pjesa-1-dhe-2-pdf>

Si fakte në bazë të të cilave shfaqet elementi i huaj në objekt të marrëdhënies juridiko-private me element të huaj janë në vendin se ku gjendet sendi dhe përkatësia (nacionaliteti) i mjeteve themelore të transporti (aeroplanit, anijes dhe hekurudhës). Faktet e identifikimit në të drejta dhe detyrime të marrëdhënies juridiko-private - si fakte në bazë të të cilave konstatohet prezenca e elementit të huaj në të drejta dhe detyrime janë:

- *vendi i lidhjes së punës juridike,*
- *vendi i përmbushjes së punës juridike,*
- *vendi i selisë së Gjykatës para së cilës shtrohet çështja e plotfuqishmërisë së punës juridike dhe*
- *vendi ku është kryer veprimi kundë ligjor.*

### 1.5 Parimet themelore të vendbanimit

Parimet themelore të vendbanimit me element të huaj ekzistojnë dy mënyra: Direkte dhe Indirekte.

- ❖ **Mënyra direkte** – (e drejtpërdrejtë) e rregullimit të marrëdhënies juridiko-private me element të huaj- sipas kësaj mënyre marrëdhëniet juridiko-private me element të huaj rregullohen me norma juridike të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë e rregullojnë marrëdhënien konkrete në tërësi dhe përfundimisht duke i zbatuar vetëm normat substanciale të sistemit juridiktë vendit.
- ❖ **Mënyra indirekte**, e kolizionit e rregullimit të marrëdhënies juridiko-private me element të huaj nuk rregullohet drejtpërsëdrejti, por përcaktohet se cila e drejtë do të zbatohet drejta e vendit apo e drejta e shtetit të huaj që të rregullohet marrëdhënia konkrete nëpërgjithësi. Instrumentet themelore dhe esenciale të mënyrës indirekte të rregullimit janë normat specifike që quhen normat e kolizionit.<sup>5</sup>(Shala, 2012, pp. 11, 12)

---

<sup>5</sup>Drita Shala; E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 3 dhjetor, 2012, pg, 11  
<https://www.slideshare.net/dritashala/e-drejta-ndrkomtbare-private>



## 2. KAPITULLI II

### Kuptimi dhe llojet e vendbanimit si fakt i identifikimit

#### 2.1 Vendbanimi (domicili) si fakt identifikimi

Vendbanimi (domicili) njëlloj sikurse edhe shtetësia paraqitet si fakt identifikimi (fakt në bazë të të cilit krijohet elementi i huaj) në bazë të të cilit konstatohet prezenca (prania) e elementit të huaj juridiko- privat në subjekt.

Në të drejtën ndërkombëtare private vendbanimi (domicili) është qendër e mardhënieve jetësore të një personi në një shtet të caktuar, që do të thotë se për të DNP është me rëndësi se ku ndodhet ajo qendër respektivisht në cilin shtet, dhe nuk është me rëndësi se në cilin vend (qytet) në kuadër të atij shteti.

Sikurse në të drejtën e brendshme ashtu edhe në DNP ekzistojnë dy lloje të vendbanimit:

**1. vendbanimi me dëshirë (*domicilium voluntarium*)**

**2. vendbanimi ligjor (*domicilium necesarium*)**

**1. Vendbanimi me dëshirë (*domicilium voluntarium*)** - Është qendra e mardhënieve jetësore të një personi në një shtet, e cila krijohet kur një person gjithmonë vendoset në atë shtet me qëllim që aty të banoj përgjithmonë. Mirëpo jo të gjitha shtetet i pranojnë këto dy elemente:

- Qëllimi që të vendoset në një shtet përgjithmonë dhe
- Vendosja e përhershme në atë shtet. (Cilësimi para gjykatës gjithmonë zgjidhet sipas *lex fori*)

**2. Vendbanimi ligjor (*domicilium necesarium*)** - Është ajo qendër e mardhënieve jetësore që me ligj i caktohet kategorisë së caktuar të personave në një shtet për t'u mbrojtur interesat e tyre si dhe interesat e rrethit ku jetojnë ata.

Në sistemet juridike të shteteve të ndryshme vendbanimi ligjor parashihet për kategori të ndryshme të personave, dhe ata: për persona që nuk kanë zotësi veprimi - në të gjitha shtetet konsiderohen personat e mitur dhe personat e sëmurë psiçik, kurse në disa shtete edhe plangprishësit dhe pijanecët që janë vënë nën kujdestari. Përfaqësuesit diplomatik dhe personat me status diplomatik – konsiderohen se kanë banim në vendin e shtetit ku shërbejnë. Për këtë çështje nuk shqyrtohet problemi i cilësimit.

Për funksionarët e lartë – në disa shtete parashihet vendbanim i veçantë. (Mustafa, 2016) Përfaqësuesit diplomatik dhe personat me status diplomatik, respektivisht ata që gëzojnë imunitet gjyqësor, konsiderohet se e kanë vendbanimin në shtetin që e përfaqësojnë, jo në shtetin ku janë të akredituar.

Lidhur me këtë çështje, qëndrim të njëjtë kanë të gjitha shtetet andaj nuk shtrohet problem i cilësimit. Për funksionarët e lartë, në sistemet juridike të disa shteteve parashihet vendbanimi i veçantë (p.sh; Kancelari federal i Zvicrës e ka vendbanimin në Bern, gjithashtu gjykatësit federal, etj.)<sup>6</sup>(DOKUMEN.TIPS Indonesia, 2015)

Për tregtarët – në disa shtete caktohet vendbanimi special, aty ku janë regjistruar në regjistrin tregtar ose ku e kanë selinë kryesore, por vetëm për marrëdhënie që janë të lidhura me ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

**3. Vendbanimi sipas origjinës** – Është një lloj i veçantë i vendbanimit ligjor, i cili ekziston në disa shtete anglo-saksone. Krijohet nga momenti i lindjes, nuk ndryshohet me fitimin e zotësisë së veprimit (moshes madhore) dhe e përcjellë personin deri në vdekje. Ai caktohet në atë shtet ku e ka vendbanimin prindi (i ati) i tij në momentin e lindjes së fëmijut.

**4. Kuazi-vendbanimi** – Për dallim nga llojet tjera të vendbanimit, ky lloj nuk është qendër e marrëdhënieve jetësore të një personinë kuptimin e plotë të fjalës.

Ekszistojnë dy lloje të tij :

- a) Kuazi-vendbanimi i zgjedhur - i cili është fikcion për ekzistimin e vendbanimit e ka prejardhjen nga Franca (domicile elu) dhe ekziston në disa shtete (romane).

Palët kontraktuese me marrëveshje e caktojnë një vendbanim të përbashkët për të

---

<sup>6</sup>DOKUMEN.TIPS Indonesia; 10-Oct-2015 <https://dokumen.tips/documents/2-shtetesia-si-fakt-vendimtar.html>

dy palët dhe vlenë vetëm për atë mardhënie juridike. Në këtë mënyrë palët heshtazi e caktojnë edhe kompetencën e gjykatës

- b) Kuazi-vendbanimi i notifikacionit - gjithashtu nuk është qendër e marrëdhënieve jetësore të një personi, por është vendi i caktuar nga i huaji për personin e autorizuar për pranimin dhe dorëzimin e shkresave gjyqësore në rastet kur i huaji nuk ka vendbanim në shtetin ku zhvillohet procedura gjyqësore. <sup>7</sup>(Mustafa, 2016)

## 2.1 Vendbanimi si fakt vendimtar dhe si faktsubsiar

Janë elementi i tretë i formimit dhe zbatimit të normës së DNP, roli i së cilave është përcaktimi i rendit juridik konkret, normat e të cilit do të zbatohen për zgjidhjen e marrëdhënieve juridike konkrete me element të huaj. (Gashi, p. 3) Vendbanimi paraqitet si fakt vendimtar në bazë të të cilit përcaktohet zbatimi i së drejtës së shtetit të vendit ose të huaj dhe përcaktohet kompetenca e gjykatës së shtetit të vendit ose të huaj (dhe për mundësinë e ushtrimit-gëzimit të të drejtave të caktuara civile nga të huajt në teritorin e shtetit të vendit) të mardhëniet statusore dhe trashëgimore me element të huaj, edhe atë, kryesisht të shtetave të imigracionit. Në shtetet e imigracionit, vendbanimi si fakt vendimtar e ka rolin e njëjtë sikurse shtetësia të shtetave të emigracionit, tek të cilat gjithashtu paraqitet por ka rol subsidiar, paraqitet të mardhëniet statusore dhe trashëgimore me element të huaj. <sup>8</sup>

### 2.2.1 Vendi i lidhjes së kontratës si fakt vendimtarë për rregullimin e përmbajtjes së kontratës

Vendi i lidhjes së kontratës (lex loci contractus) është fakt më i vjetërvendimtarë, prejardhjen e ka që nga koha e Bartoleusit. Me zhvillimin intensiv të komunikacionit dhe formave të llojllojshme të komunikimit përmes telefonit, telefaksit, teleprinterit, fax-it,

---

<sup>7</sup> Refik Mustafa; Përmbledhje: E drejta ndërkombëtare private, 27 Qershor, 2016

<sup>8</sup> Refik Mustafa; vep, e cit., fq,43

email-it etj. gjithnjë e më vështirë përcaktohet vendi i lidhjes së kontratës, shpesh mund të jetë irëndësishëm, p.sh. njëra palë është në kalim e sipër ose kontrata lidhet në mungesë, në kushtebashkëkohore ligji i vendit të lidhjes së kontratës zbatohet si fakt vendimtarë ndihmës.

### **2.2.2 Vendi i përmbushjes së kontratës si fakt vendimtarë për rregullimin e përmbajtjes së kontratës**

Vendi i përmbushjes së kontratës mund të jetë i rastësishëm ngase ai është vendiku kontrata duhet të përmbushet dhe se lidhshmëria me vendin e përmbushjes çdo herë është organike, vendi i lidhjes së kontratës mund të jetë i rastësishëm, ndërsa vendi i përmbushjes së kontratës është fakt vendimtarë i sigurt ku kontrata duhet të përmbushet.

### **2.2.3 Vendbanimi ose selia e debitorit të detyrimit karakteristike si fakt vendimtar**

Në teorinë dhe praktikën e shteteve të ndryshme vendbanimi i borxhliut të detyrimit si karakteristikë gjithnjë e më tepër zbatohet si fakt vendimtarë, kjo lidhje nuk është e rastësishme por është etheksuar dhe e fuqishme dhe relativisht lehtë mund të provohet, ky fakt vendimtarë zbatohet edhe në Konventën e Hagës për të drejtën e cila zbatohet për shitjen e mallrave 1986.

Lidhshmëria më e afërt si fakt vendimtarë për caktimin e të drejtës kompetente - parimi i lidhshmërisë më të ngushtë sipas të gjitha gjasave ka filluar të zbatohet në sistemin juridik Anglez, kah fundi i shekullit të kaluar, parimi i lidhshmërisë më të afërt bënë pjesë në faktet vendimtare suazore të cilat vlerësimin e lidhjes juridike me marrëdhënien konkrete nuk e kabërë paraprakisht ligdhënësi, por kjo çështje i lihet në dispozicion gjykatësit, kështu që ligjvënësijep vetëm vendime suazore. (Shala, 2012, p. 31)

Pikat e lidhjes (faktet vendimtare)- Elementi i përgjithshëm i lidhjes së formimit dhe zhvillimit të normës të së drejtës ndërkombëtare private janë faktet vendimtare ose pikat e lidhjes (point of contact, point of attachment).

Roli i pikave të lidhjes (faktet vendimtare)- Konsiston në përcaktimin e rendit juridik konkret, normat juridike të cilat zbatohen për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-private me element të huaj dhe përcaktojnë se të drejtat civile në shtetin e vendit, a do të jenë kompetent Gjykata e shtetit të vendit apo e shtetit të huaj.

Shmangiet nga normat kompetente të së DNP- dmth kur ligjdhënësi i një shteti në bazë të elementeve të përgjithshme të theksuara më sipër e formëson normën e së DNP, organi para të cilit shtrohet çështja që duhet ti zbatoj normat e sistemit juridik të atij shteti nuk do të thotë se duhet patjetër të veproj sipas atyre normave. Shmangiet që aplikohen në të gjitha tërësitë që sajohen në të DNP.<sup>9</sup>(Shala, 2012, p. 11)

Kur flasim për personat fizik si fakt identifikimi paraqitet vendbanimi, mirëpo kur flasim për personat juridik kjo bëhet me përkatësinë (nacionalitetin) e personave juridik, I cili në rastin konkret paraqitet si një fakt i caktuar në kuadër të së cilit fakt formohet elementi i huaj juridiko – privat.

Në literaturë kur flitet për përkatësinë apo nacionalitetin, personat juridik ndahen në dy lloje:

- a) Personat juridik që kanë nacionalitetin e një shteti konkret dhe;
- b) Personat juridik ndërkombëtar<sup>10</sup>

Në kuadër të kësaj paraqitet pasqyrë që ka persona juridik të atillë që realisht kanë nacionalitet të një shteti, respektivisht I takojnë një shteti të caktuar dhe ka persona juridik të cilët janë ndërkombëtar. Më tej do ta sqarojmë aspektin se çka nënkuptohet me persona juridik që kanë nacionalitetin e një shteti konkret dhe me persona juridik ndërkombëtar.

Personat juridik që i takojnë një shteti, përkatësisht që kanë përkatësinë (nacionalitetin) e atij shteti – janë personat juridik të së drejtës civile (private) dhe shteti. Personi juridik është krijesë shoqërore të cilës sistemi (rendi) ia njeh zotësinë juridike,

---

<sup>9</sup> Drita Shala; vep. e cit., fq. 31, 11

<sup>10</sup> Bilalli, Asllan, Kuçi, Hajredin, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2012, fq. 244

qëdo të thotë se sistemi juridik krijesës shoqërore mund t'ia njeh cilësinë e subjektit juridik, respektivisht të jetë bartës i të drejtave dhe detyrimeve edhe pse një krijesë e tillë plotësisht dallohet nga njeriu, nga personi fizik.

Në literaturë, përcaktohet se pranimiti zotësisë juridike, krijesave të caktuara shoqërore paraqitet si nevojë e kërkesave konkrete shoqërore që ia ka imponuar jeta shoqërore dhe ekonomike. Pos kësaj, për arritjen e qëllimeve të caktuara ekonomike nevojitet një periudhë kohore relativisht e gjatë që dukshëm e tejkalon kohëzgjatjen e jetës mesatare njerëzore.<sup>11</sup>

Në bazë të kësaj e shohim që tek këto persona realisht faktorët ekonomiko – shoqërore kanë një ndikim shumë të madhë sipas të cilës madje edhe formohen këto persona juridik. Realisht, këtu përcaktohet nacionaliteti ose përkatësia e këtyre personave, ku dihet saktë se cilit shtet i takojnë dhe në kuadër të atij shteti cilat janë të drejtat dhe detyrimet e këtyre personave juridik, andaj është e rëndësishme të bëhet dallimi i personave juridik që i takojnë një shteti të caktuar, pra që kanë nacionalitetin e një shteti tjetër dhe personave juridik ndërkombëtar.

Personat juridik ndërkombëtar – edhe personat juridik ndërkombëtar paraqiten si subjekte të marrëdhnieve juridiko-private me element të huaj, por për dallim nga subjektet juridik që i takojnë një shteti konkret, paraqiten shumë më vonë, diku ka fundi i shekullit XIX.<sup>12</sup>

Në literaturë përcaktohet në mënyrë decide që, përderisa personat fizik zotësinë (subjektivitetin) juridike e fitojnë me lindjen në territorin e shtetit, e jo pse janë shtetas të një shteti (e kanë shtetësinë e atij shteti), personat juridik e fitojnë subjektivitetin (zotësinë) juridike në qoftë se një shtet i pranon si persona juridik.<sup>13</sup>

Nga këtu vërehet edhe njëri nga dallimet mes personave fizik dhe personave juridik, e që është fakti që personat fizik zotësinë juridike e fitojnë me lindje edhe atë e fitojnë me lindje në territorin e një shteti dhe kjo zotësi nuk është si rezultat i shtetësisë të cilën ata e kanë, por kjo është rezultat me faktin e lindjes së gjallë dhe në territorin e një shteti të caktuar, përderisa një gjë e tillë nuk është për personat juridik që nënkupton që këto

---

<sup>11</sup> Ibidem, fq. 244

<sup>12</sup> Bilalli, Asllan, Kuçi, Hajredin, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2012, fq. 248

<sup>13</sup> Ibidem, fq. 248

persona subjektivitetin e tyre e fitojnë vetëm atëher kur një shtet i caktuar i pranon si persona juridik<sup>14</sup>.

Në teorinë juridike egzistojnë qëndrime të ndryshme lidhur me kriteret sipas të cilave do të caktohet përkatësia (nacionaliteti) i personave juridik, si në planin ndërkombëtar ashtu edhe në kuadër të sistemeve juridike të shteteve të ndryshme. Për këtë arsye, nuk është e rastit që shtetet e ndryshme personin e njejtë juridik e trajtojnë me përkatësi (nacionalitet) të vendit osë të huaj. Nga kjo është e vështirë të përcaktohet përkatësia (nacionaliteti) i kompanive multinacionale ngase shpesh ndodh që një ndërmarrje tregtare për nga emri t’I përkasë ( të ketë nacionalitetin) e një shteti, sipas selisë shtetit tjetër, kurse sipas ushtrimit të veprimtarisë, shtetit të tretë.<sup>15</sup>

Në momentin që flasim për këtë e shohim qartë që ka është e nevojshme të ketë kritere të caktuara, mbase në praktikë mund të paraqiten raste të tilla të cilat e kërkojnë një gjë të tilla. Sa i përkët kësaj, shohim qartë që ka ndërmarrje të shumta të cilat veprimtarinë e tyre, mënyrën e funksionimit, punën e tyre e kanë të zgjeruar në më shumë territore dhe si rezultat i kësaj nevojitet të ketë kritere të caktuara që të dihet në mënyrë strikte përkatësia ose nacionaliteti i kësaj ndërmarrjeje.<sup>16</sup>

Kur flasim për këtë është mjaftë e rëndësishme të dimë se si bëhet caktimi I përkatësisë në situata të caktuara, mbase egzistojnë disa forma të caktimit të përkatësisë të cilat i njeh teoria juridike dhe të njejtat i ndan në:<sup>17</sup>

- 1) Caktimi i nacionalitetit (përkatësisë) të personave juridik në rrethana normale – në kuadër të kësaj si fakte bazë të cilave caktohet përkatësia e personave juridik në rrethana normale, në sistemet juridike të shteteve zbatohen më tepër kritere dhe atë:<sup>18</sup>

---

<sup>14</sup> Ibidem, fq. 249

<sup>15</sup> Bilalli, Asllan, Kuçi, Hajredin, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2012, fq. 249

<sup>16</sup> Ibidem, fq. 249

<sup>17</sup> Ibidem, fq. 251

<sup>18</sup> Ibidem, fq. 251

- a) Përkatësia e personave juridik caktohet sipas vendit të selisë së administratës: këtë sistem e zbatojnë më tepër shtete të Evropës Kontinentale. Sipas këtij kriteri, personi juridik e ka nacionalitetin (përkatësinë) e shtetit në të cilin faktikisht ndodhet selia e organit kryesor<sup>19</sup>.
- b) Përkatësia e personit juridik caktohet sipas vendit të regjistrimit (themelimit) të tij – sipas këtij kriteri, personi juridik e ka nacionalitetin (përkatësinë) e atij shteti në të cilin është regjistruar. Arsyeja e vërtet për zbatimin e këtij kriteri, si kusht për konstatimin e përkatësisë së personave juridik, më së miri mund të kuptohet kur merren parasysh raportet të të cilat përkatësia e personit juridik merret si fakt vendimtar (pikët e lidhjes) <sup>20</sup>
- c) Përkatësia e personit juridik caktohet sipas qendrës së eksplotimit, përkatësishtë qendrës së aktiviteteve ekonomike – sipas këtij kriteri përkatësia e personit juridik caktohet sipas qendrës së aktiviteteve ekonomike të personit juridik (ku ndodhet fabrika).

Sipas këtij sistemi, personi juridik edhe pse e ka përkatësinë e shtetit tjetër ose atje ndodhet udhëheqësia e tij, do të konsiderohet si i vendit në qoftë se aty është qendra e aktiviteteve të tij. <sup>21</sup>

- 2) Caktimi i nacionalitetit (përkatësisë) të personave juridik në rrethana të jashtëzakonshme (gjendje lufte) – në rrethana të jashtëzakonshme, sidomos në gjendje lufte si kriter, përkatësishtë si fakt në bazë të cilit caktohet përkatësia e personit juridik (fakt identifikimi) merret se kush e bën kontrollin e kapitalit të atij personi juridik.<sup>22</sup>
- 3) Kolizioni (konflikti) i përkatësisë së personave juridik – gjatë caktimit të përkatësisë (nacionalitetit) të personave juridik, çdo shtet i cakton kriteret. Për këtë arsye egziston mundësia që të shfaqet kolizioni i përkatësisë së personit juridik, ngase sistemet juridike të shteteve të ndryshme dallohen mes veti<sup>23</sup>.

<sup>19</sup> Bilalli, Asllan, Kuçi, Hajredin, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2012, fq. 251

<sup>20</sup> Bilalli, Asllan, Kuçi, Hajredin, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2012, fq. 251

<sup>21</sup> Ibidem fq. 250 - 251

<sup>22</sup> Ibidem, fq. 251

<sup>23</sup> Ibidem, fq. 252



Si rezultat i kësaj shfaqet kolizioni pozitiv lidhur me përkatësinë e personave juridik, kur dy ose më tepër shtete pretendojnë se personi konkret juridik e ka nacionalitetin e tyre. Te ky lloj kolizioni për përkatësinë e personave juridik, njëloj sikurse edhe te kolizioni i shtetësisë të personave fizik janë të mundshme dy situata:<sup>24</sup>

- 1) Në rastin e parë, kur organi i shtetit para të cilit shtrohet çështja e nacionalitetit të personit juridik e konsideron atë si të vetin, atëherë ai person juridik do ta ketë nacionalitetin e atij shteti.<sup>25</sup>

Nga kjo e kemi të qartë që në rastet kur organi i shtetit para të cilit trajtohet kjo çështje lidhur me atë se ky person juridik është apo nuk është i tij dhe ky organ i cili në rastin konkret duhet të sqaron lidhur me përkatësinë e këtij personi juridik dhe deklarohet që ky person juridik është i tij, atëherë në këtë rast ky person juridik do ta ketë nacionalitetin e atij shteti.<sup>26</sup>

- 2) Në rastin e dytë kur shtrohet çështja e përkatësisë së personit juridik para organeve të një shteti, kurse dy ose më tepër shtete konsiderojnë se ai person juridik e ka nacionalitetin e tyre, kurse qëndrim të tillë nuk ka shteti para gjykatës të cilit shtrohet çështja, atëherë nga kjo gjykatë zbatohet njëri nga sistemet sipas të cilëve caktohet përkatësia e personit juridik sipas sistemit juridik të atij shteti.<sup>27</sup>

Rasti i dytë është një rast i cili dallon me rastin e parë të lartshënuar, ngase në rastin e parë organi i shtetit para të cilit është shtruar kjo çështje deklarohet se personi juridik i caktuar ka përkatësinë, respektivisht nacionalitetin e atij shteti, me të cilin më pas ky person juridik edhe do ta ketë nacionalitetin e atij shteti, përderisa në rastin e dytë kemi të bëjmë me disa shtete të cilët sqarojnë që personi juridik i caktuar ka nacionalitetin e tyre, mirëpo shteti, përkatësisht organi kompetent para

---

<sup>24</sup> Bilalli, Asllan, Kuçi, Hajredin, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2012, fq. 252 - 253

<sup>25</sup> Bilalli, Asllan, Kuçi, Hajredin, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2012, fq. 252 - 253

<sup>26</sup> Ibidem, fq. 252 - 253

<sup>27</sup> Ibidem, fq.253

të cilit shtrohet çështja nuk ka një qëndrim të tillë, atëherë nga kjo gjykatë zbatohet njëri nga sistemet sipas të cilave caktohet përkatësia ose nacionaliteti e personit juridik sipas sistemit juridik të atij shteti.<sup>28</sup>

---

<sup>28</sup> Bilalli, Asllan, Kuçi, Hajredin, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2012, fq.253

## KAPITULLI III

### 3. Faktet e vendimtare (Pikat e lidhjes)

Roli i tyre konsiston ne percaktimin e rendit juridik konkret te shtetit te vendit ose te huaj, normat juridike tecilit do te zbatohen per rregullimin e marrëdhënies juridiko-private me element të huaj dhe të percaktojnë se i huaji a mund të gezojë (ushtrojë të drejta konkrete civile në shtetin e vendit dhe se a do të jetë kompetenttegjykata e shtetit të vendit ose e shtetit të huaj.

#### 3.1 Shmangiet nga normat kompetente të së drejtës ndërkombëtare private - korrektimi i kolizioneve

Shmangiet nga normat e të drejtës ndërkombetare private (faktet vendimtare) karakterizohen në dy grupe edhe atë:

- a) Shmangiet që zbatohen te të gjitha tërësitë që e sajjnë të drejtën ndërkombëtare private, përkatesisht rendin publik ndërkombëtare dhe bishterimi i ligjit. Këto zbatohen te të gjitha tërësitë dhe te të drejtat civile të të huajve, kolizioni i juridiksioneve dhe kolizioni i ligjeve.
- b) Ridergimi dhe retorsioni që zbatohen te disa tërësi që e sajjnë të drejtën ndërkombëtare private. Ridergimi zbatohet te disa tërësi që e sajjnë të drejtën ndërkombëtare private përkatesisht zbatohet te kolizionii juridiksioneve dhe kolizioni i ligjeve. Retorsioni zbatohet vetëm te tërësia e të drejtave civile të huajve dhe kolizioni i juridiksioneve.<sup>29</sup>(Duraku, p. 11)

#### 3.2 Vendbanimi si fakt vendimtar primar, roli i tij

Vendbanimi në shtetet e imigracionit ka të njëjtin rol dhe rëndësi si fakt vendimtar (pikë e lidhjes) që e ka shtetësia në shtetet e emigracionit.<sup>30</sup>(Mustafa, 2016, p. 43)  
Ato e përcaktojnë se sipas cilave norma do të zgjidhet çështja konkrete.

---

<sup>29</sup>Rino Duraku; vep. e cit., fq, 11

<sup>30</sup> Refik Mustafa; vep, e cit., fq,43

### **3.1.1 Vendbanimi si fakt vendimtar**

Vendbanimi shërben si fakt vendimtar primar (Parësor) tek shtetet eimigracionit dhe si fakt Subsidiar apo (Dytësor), tek shtetet e emigracionit, për zbatimin e të drejtës së shtetit të vendit apo shtetit të huaj, për përcaktimin e kompetencës së Gjykatës së vendit apo gjykatës së huaj, dhe për mundësinë e ushtrimit të të drejtave konkrete civile nga të huajt në territorin e shtetit të vendit.

(Pra, shërben për me përcaktim të drejtën kompetente, a është e drejta jonë a e shtetit të huaj, edhe Gjykatën kompetente tonë a të huaj, edhe për me treguar se a kanë të drejtë njerzit e huaj në shtetin tonë).<sup>31</sup>(Gashi, p. 7)

### **3.2.2 Vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar**

Vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar për caktimin e kompetencës së organit gjyqësor – në shtetet e emigracionit, vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar ka rëndësi më të madhe gjatë caktimit të kompetencës së gjykatës, respektivisht shtetet e emigracionit të cilat e zbatojnë shtetësinë si fakt vendimtar primar të mardhëniet statusore dhe trashëgimore me element të huaj, vendbanimi (domicili) shërben si fakt vendimtar subsidiar për caktimin e kompetencës së gjykatës në shumicën e këtyre shteteve kur shtrohet çështja e shkurorëzimit të martesave të përziara.

Gjithashtu, vendbanimi është fakt vendimtar në të drejtën ndërkombëtare procedurale sipas ligjit për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve, ku vjen në shprehje posaqërisht gjatë përcaktimit të kompetencës ekskluzive të gjykatës, të kontestet martesore.

Vendbanimi shërben si fakt vendimtar subsidiar për rregullimin e mardhënieve të njëjta të personave bipatridë apo apatridë.

### **3.2.3 Vendqëndrimi i rregullt dhe vendqëndrim i pa rregullt**

---

<sup>31</sup> Yllka Gashi; vep. e cit., fq. 3,7

Termi vendqëndrimi irregullt rrjedh nga fjala gjermane (geöhlichen Aufenthalt) dhe si duket do të zëvendesojë vendbnimin në tëardhmen si nocion juridik sëpaku kur janë në pyetje traktatet nderkombëtare. Elementi i përbashkët konstituiv i vendbanimit dhe vendqëndrimit është qëndrimi në një teritor të caktuar. Ky qëndrim duhet të jetë konstant. Kështu vendqëndrimi i rregullt i një personi është në Shkup ,por momentalisht qëndron në Mavrovë për skijim. Gjithashtu ,vendqëndrimi dhe vendqëndrimi i rregullt dallohen nga vendbanimi edhe për nga elementi i dytë konstitutiv përderisa të vendbanimi duhet të vijë në shprehje dëshira për të jetuar përgjithmon në një vend të vendqëndrimi i rregullt kjo dëshirë nuk egziston por egziston shprehja e qëndrimit të rregullt i cili është vendbanimi ku i mungon elementi subjektiv dhe është koncept fakti i cili shfrytëzohet nga juristët.

Dallimi egziston edhe në elementin e tretë, respektivisht të zotësia e veprimit e cila kërkohet të vendbanimi, kurse vendqëndrimi i rregullt është koncept faktik dhe nuk nevojitet kjo zotësi për krijimin e vendqëndrimit, kështu që mund ta kenë edhe të miturit.

Vendqëndrimi është gjithashtu edhe fakt vendimtar (pikë e lidhjes) të mardhënjet statusore ,por është fakt vendimtar subsudiar dhe aplikohet në mungesë të fakteve tjera vendimtare .Një person ,vendqëndrimin e ka në vendin ku fizikisht qëndron dhe mund të vërehet se mungon elementi i vullnetit, dëshira që personi përgjithmon aty të vendoset .Që të egzistojë vendqëndrimi i rregullt duhet qëndrimi në një vend të zgjas një kohë më të gjatë, kështu që mund të thuhet se personi në atë shtet e ka qendrën e marrëdhënjeve jetësore.

Vendqëndrimi i rregullt konsiderohet si një lloj i vendbanimit faktik, kurse dallohet nga nocioni i vendbanimit kryesisht për arsye se në shumë sisteme juridike personi mund të ketë më tepër vendbanimi faktik, kurse dallohet nga nocioni i vendbanimit kryesisht për arsye se në shumë sisteme juridike personi mund të ket më teper vendbanime të rregullta. Ndërsa personat që nuk kanë zotësi veprimi, egziston i ashtuquajtur i vendbanim i

derivuar, kurse nga ana tjetër, këta persona mund të kenë vendqëndrim të rregullt me supozim se janë ambientuar në rrethin ku jetojnë.<sup>32</sup>

### **3.2.4 Vendbanimi si fakt identifikimi tek personat me element të huaj juridiko privat**

Elementi I huaj juridiko privat është i shprehur si lloji i gjinive të ndryshme, kur elementet e marrdhënies juridike janë të lidhuara me dy ose më tepër sovranitete të huaja të ndryshme. Për shembull kur lidhin martesë shtetasi anglez dhe shtetësi italian në Republikën e Kosovës. Elementi I huaj juridiko privat shprehet si i thjeshtë dhe unik dhe i një lloji në qoftëse në marrdhënien juridiko private si i huaj shprehet vetëm një element i marrëdhënies i cili element i marrëdhënies juridikisht është lidhur vetëm me një sovranitet.

Elementi i huaj juridiko privat shprehet I thjeshtë ose i përzier dhe i një lloji gjinie, në qoftëse në marrëdhënien juridiko civile si i huaj shfaqet vetëm një element i marrëdhënies i cili njëkohësisht shprehet si vendit dhe si i huaj, ku të shprehurit e tij si huaj lidhet vetëm me një sovranitet të huaj të njëjt. Ndërsa elementi i huaj juridiko –privat shprehet si i thjeshtë dhe i përzier, ku i llojeve të ndryshme në qoftëse në marrëdhënien juridiko private si i huaj shprehet vetëm një element i marrëdhënies i cili njëkohësisht shprehet si i vendit dhe si i huaj ku të shprehurit e tij si i huaj lidhet së paku me dy ose më tepër sovranitete të huaja. Elementi i huaj juridiko privat shprehet si I shumëfishtë unik dhe i llojeve të ndryshme, në qoftëse në marrëdhënien juridiko private si të huaj janë të shprehur së paku dy ose të gjitha elementet e marrëdhënies, ku çdonjëri nga elementet e marrëdhënies ose ndonjë prej tyre juridikisht janë të lidhura për dy ose më tepër sovranitete të huaja.

Elementi i huaj juridiko privat shprehet si i shumëfishtë i përzier dhe i një lloji në qoftëse në marrëdhënien juridiko-private si të huaj janë të shprehur së paku dy ose të gjitha elementet e marrëdhënies, ku çdonjëri nga elementet e marrëdhënies ose ndonjëra prej tyre njëkohësisht është lidhur edhe me sovranitetin e shtetit të vendit edhe me njësovranitet të

---

<sup>32</sup>E drejta Nërkombe të Private, Pjesa e përgjithshme, Asllan Billalli, Hajredin Kuci

shtetit të huaj. Për shembull në qoftëse ndër marrja kosovare lidh kontratë me ndërmarrjen austriake për shitblerjen e një sasive të rakisë së rrushit e cila pjesërisht ndodhet në Republikën e Kosovës.

Elementi I huaj juridiko privat shprehet si i shumëfishtëi përzier dhe i llojeve të ndryshme, në qoftëse në një marrëdhënie juridiko private si të huaj janë të shprehur së paku dy ose të gjitha elementet e marrëdhënies, ku çdonjëri nga elementet ose ndonjëri prej tyre njëkohësisht është lidhur edhe me sovranitetin e huaj <sup>33</sup>

### **3.2.5 Faktet vendimtare për rregullimin e përmbajtjes së marrëdhënieve kontraktuese me element të huaj**

Tek marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike, përkatësisht marrëdhëniet juridiko-private me element të huaj, zbatohen rregulla të përbashkta, faktet vendimtare unike për caktimin e formës së këtyre marrëdhënieve detyimore në të gjitha shtetet, por jo çdo herë për të njëjtat raste, zbatohen rregulla *locus regit actum*. Arsyeshmeria dhe zbatimi i së drejtës materiale të vendit të lidhjes së punës juridike, arsyetohet me faktin se dispozitat për formën në çdo shtet u përshtatën specifikat të sistemit juridik, tradhëtisë, nivelit të zhvillimit ekonomik, moralit, kulturës.

Zbatimi i rregullës *locus regit actum* si fakt vendimtar shfaqet në shekullin XII nga përfaqësuesit e shkollës Italiane të statuesve në formën e punëve juridike ka pasur një rëndësi të madhe në ndikimin e të drejtës kanotike në lëmi të konkrete, kurse në përgjithësi është respektuar vullneti i palëve lidhur me formën e punës juridike.

Që nga ajo kohë juristët kanë paraparë kritere (fakte vendimtare) që zbatohen edhe sot, sipas të cilëve forma e punëve juridike caktohet sipas vendit të krijimit të tyre, pika e lidhjes duhet të lehtësojë zhvillimin e qarkullimit juridik në përmasa ndërkombëtare në raste ku akti juridik ndërrmeret në territorin e shtetit tjetër midis shtetasve të vendit, ku dispozitat për formën dallohen dhe pamundesojnë krijimin e aktit juridik.

---

<sup>33</sup>E drejta Nërkombëtare Private, Pjesa e përgjithshme, Asllan Billalli, Hajredin Kuci

Fakti vendimtar locus actum zbatohet tek të gjitha aktet juridike duke përfshirë jo vetëm deklarin e vullnetit të palëve për formën, por edhe për procedurën para organit administrativ ose gjyqësor, si për shembull lidhur me procesverbalin për kujdestarinë, adoptimin, hartimin e testamentit para gjykatës.<sup>34</sup>

---

<sup>34</sup>E drejta Nërkombëtare Private ,Pjesa e përgjithshme, Asllan Billalli, Hajredin Kuci



## KAPITULLI IV

### 4 Shtetësia si pikë e lidhjes –Efektet e shtetësisë

Fakte ose nocione juridike përmes të cilave kuptohet se në marrëdhënien konkrete juridike – private a është shprehur elementi i huaj juridik- privat ose jo respektivisht në marrëdhënie konkrete juridiko- private me elemente të huaja a janë lidhur një osë më tepër elemente të marrëdhënies me shtetin e huaj . Në temën time do të paraqes faktet e indentifikimit si fakte në bazë të së cilave krijohet elementi i huaj juridiko privat në subjekt pra shtetësia, venbanimi dhe përkatësia e personave juridik mund të paraqiten të gjitha kategoritë juridiko- private me element të huaj edhe të marrëdhëniet statusore, trashifimore, juridike-sendore dhe marrëdhënieve detyrimimore me elemente të huaj.

Mjafton të konstatohet se personi i cili mer pjesë në cilën do qoftë marrëdhënie juridiko- private nuk ka vendbanim në territorin e shtetit të vendit ose në qoftë se është person juridik nuk e ka përkatësinë e shtetit të vendit që konstatohet se marrëdhënia në fjalë nuk rregullohet me dispozitat e së drejtës së brendshme por i takon lëmisë së regullimit të së Drejtës ndërkombëtare private. Shtetësia nuk paraqitet tek të gjitha marrëdhëniet juridike-private me elemente të huaja. Marrëdhëniet tek të cilat shtetësia paraqitet si fakt vendimtarë janë marrëdhëniet statusore dhe marrëdhëniet trashëgimore. Kjo temë ka për qëllim që të paraqes shtetësinë e cila në disa shtete nuk është pranuar si fakt vendimtarë. Deri ka fundi i shekullit XVIII, ekskluzivisht si fakt vendimtarë është zbatuar vendbanimi. Kodi Civil Francez i vitit 1804 në nenin 3 e ka paraparë shtetësinë si fakt vendimtarë.

Nën ndikimin e teorisë së Mançinit nga viti 1865, shtetësia si fakt vendimtarë fiton përkrahje të gjërë dhe depërton pothuajse në të gjitha sistemet juridike të Evropës Kontinentale, me përjashtim të Britanisë së Madhe dhe shteteve Skandinave si dhe një numër i shteteve të Azisë dhe Afrikës. Shtete e Evropës Kontinentale respektivisht shtetet

nga të cilat migron një numër i marrëdhënive statusore të shtetasve të tyre, çdo herë të zbatohet e drejta e tyre Lex nationalis.

Zbatimi i shtetësisë është lidhje juridike midis personit fizik dhe shtetit konkret, që i mundëson personin një status të caktuar. Në qoftë se respektohet sovraniteti i shteteve, këtë status të subjektit mund të ndryshojë vetëm ai sovranitet që ia ka dhënë subjektiti. Përcaktimi i fakteve vendimtare, që do të ndikojë tek rregullimi i marrëdhënive statusore është me rëndësi të veçantë zbatohet e drejta e vendit ose e huaj për arsye se egzistojnë dalime të mëdha rreth rregullimit të kësaj materie. Kështu për shembull tek zotësia juridike moshë madhore dukshëm ndryshon ngase në disa shtete ajo fitohet me 18 vite moshë në disa me 21, kurse në të tjerat 25 vite. Gjithashtu dallime të mëdha ekzistojnë në legjislacionet e shteteve të ndryshme në fushën e marrëdhënive familjare. Kështu për shembull, shtetasja Norvegjeze dhe shtetasi Danez, mund të lidhin martesë në qoftë se zbatohet e Drejta Norvegjeze ose Danese por, jo edhe nëse zbatohet të themi e drejta jonë. Shtetasi i Iranit, sipas të drejtës së vet nacionale mund të lidhë martesë poligamie, por o edhe sipas së drejtës së një numri të konsiderueshëm të shteteve etj. Te shtetet e emigracionit shtetësisë zbatohet si fakt vendimtarë tek marrëdhëniet statusore dhe marrëdhëniet trashëgimore.<sup>35</sup>

Marrëdhëniet statusore me element të huaj nënkuptojmë mundësinë që personi i huaj në territorin e shtetit të vendbanimit ose shtetasi i vendit të në territorin e shtetit të huaj të krijojë marrëdhënie konkrete statusore si për shembull të lidhë martesë, adoptim, legjitim kujdestari etj. në qoftë se njëri nga elementet e marrëdhënies është i shprehur si i huaj. Ne që jemi shtetas të një vendi zakonisht i marrim të mirëqena të drejtat dhe detyrimet që shtetësia vendos mbi ne.

Shumica prej nesh mund t'i regjistrojnë fëmijët në shkolla, të kërkojmë kujdes shëndetësor kur jemi të sëmurë, të aplikojmë për punë kur kemi nevojë dhe të votojmë për të zgjedhur përfaqësuesit tanë në qeveri. Ne ndiejmë se kemi një interes në vendin ku jetojmë; ne ndiejmë një ndjesi të thellë të përkatësisë tek diçka më e madhe se vetja jonë. Por si është jeta për njerëzit të cilët nuk kanë një status shtetësie dhe të cilët janë pa të

---

<sup>35</sup> E drejta ndërkombëtare private, Asllan Billali, Hajredin Kuqi, Tetovë, 2008, fq.165

drejtën e shtetësisë? Pa pasur shtetësinë një person nuk mund të regjistrohet për të votuar në vendin ku ai/ajo jeton, nuk mund të aplikojë për dokumente udhëtimi, nuk mund të regjistrohet për martesë, etj. Në disa raste individët që janë pa shtetësi dhe janë jashtë vendit të tyre të origjinës, ose vendit të mëparshëm të banimit, mund të mbahen të ndaluar për periudha të gjata nëse ato vende refuzojnë t'i lejojnë atyre rihyrjen në territoret e tyre. Shpesh edhe të drejtat më themelore si të drejtat për arsimim, kujdes shëndetësor dhe punësim u mohohen individëve të cilët nuk mund të provojnë një lidhje ligjore me një vend të caktuar. Shtetësia është dokument zyrtar me të cilin përcaktohet përkatësia shtetërore e individëve. Kombësia është një koncept shumëdimensional, që lidhet me përkatësinë e një personi, ose të një grupi personash, të një kombi të caktuar, kulturor apo politik, ose që ka vullnetin për të egzistuar.

Gjërësia semantike e termit vjen historikisht, kryesisht për shkak të shkollave të ndryshme të mendimit në shekullin e IX-të, me tradita të kundërta: universalizmit të filozofisë franceze dhe relativizmit kulturor të nacionalizmit romantik gjerman. Pra, ne mund të flasim për kombësi politike dhe kombësi kulturore ose sociologjike. Kombësia politike përcaktohet si një provë ligjore e përkatësisë në një shtet. Kombësia nuk duhet të ngatërrohet automatikisht me shtetësinë. Shtetësia, e cila përfshin ushtrimin e të drejtave qytetare, është një koncept i dallueshëm prej kombësisë, e cila presupozon që një person fizik ose juridik duhet të jetë përcaktuar nga e drejta civile e një vendi.

Këto dy cilësi janë të lidhura pothuajse gjithmonë. Nga ana tjetër, kombësia kulturore apo sociologjike përcakton komunitetet, që nuk formojnë detyrimisht shtete të pavarura. Ata janë më shumë grupime të popullsisë në një territor pak a shumë të përcaktuar, ku ndahen ose një kombinim i veçantë i karakteristikave objektive (gjuha, feja, kultura, historia) dhe/ose karakteristika subjektive e vetë-vendosjes, shpesh e shprehur nëpërmjet nacionalizmit. Edhe pse fjala është për një fenomen të lidhur me një komunitet të individëve, përkatësia e një kombi është e lidhur me identitetin personal të secilit prej pjestarëve të saj. Një komunitet duke ndarë të njëjtën kombësi, ndajnë gjithashtu besime të përbashkëta dhe simbolet, një histori, një karakter kombëtar, një territor dhe një kulturë, që është e vecantë. Këta faktorë janë subjekt i ndryshimeve që ndodhin në kohë. Është gjithashtu e pamundur për të vendosur një standard të veçantë për secilën

karakteristikë. Kriteret e pranueshmërisë përbëjnë një tjetër element problematik kur është fjala për të identifikuar një kombësi të veçantë, ose për të vendosur kufirin me nocionin e etnisë. Duke u nisur nga kuptimi i identitetit, teoricieni politik David Miller propozon në librin e tij *On Nationality*, pesë kritere për të përcaktuar një komunitet individësh si një komb:

- Të kenë besime të përbashkëta dhe një angazhim reciprok,
- Të zënë një periudhë të përcaktuar në histori.

Miller<sup>36</sup> gjithashtu argumenton se mjetet e komunikimit brenda këtyre komuniteteve çimentojnë ndjenjat kombëtare dhe se të gjitha këto kritere luhaten me kalimin e kohës. Nga 13 mars deri 12 prill 1930, Lidhja e Kombeve organizoi Konferencën e kodifikimit të Hagës, e cila kishte për qëllim të nxirrte ligje mbi shtetësinë, shtetësinë e dyfishtë dhe apatridie. Kjo konferencë, në të cilën morrën pjesë 47 shtete, miratoi Konventën mbi disa çështje në lidhje me Konfliktin e Ligjeve mbi Kombësinë.

Kriteret për marrjen e kombësisë ndryshojnë nga një vend në një tjetër. Kombësia zakonisht fitohet në lindje, përmes birësisë (e quajtur “e drejta e gjakut”,<sup>37</sup> *jus sanguinis*).

#### 4.1 Burimet e të drejtës së shtetësisë

Njeriu duhet të njihet si **subjekt i së drejtës**, të ketë **zotësi juridike**, pra zotësi për të realizuar të drejta dhe krijuar obligime. Neni 6 i DUDNJ parasheh që çdokush dhe çdo kund ka të drejtë të pranohet/ njihet si subjekt i së drejtës. Kjo e drejtë cila njëherë është edhe bazë për gëzimin e të drejtave tjera **nuk mund ti merret askujt** pa marrë parasysh statusit të shtetësisë ose tjetër. Në doktrinën e së drejtës është e pakontestueshme që rregullimi i çështjes së shtetësisë është **materie e cila bie ekskluzivisht në juridiksion të shtetit**. E drejta në shtetësi nuk është bërë objekt i marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare

---

<sup>36</sup> Miller, D. (2000) *Citizenship and National Identity*, Cambridge: Polity Press, fq. 2

<sup>37</sup> Po aty, fq.3

nga arsyeja se shtetet insistojnë që shtetësia është raport juridik i karakterit të përhershëm që vendoset mes personit fizik dhe shtetit. Pra është e drejtë e shtetit që në mënyrë sovraane të vendos për kushtet sipas të cilave dikush mund ta fitojë, humb ose ndryshojë shtetësinë. Zakonisht aktet ndërkombëtare që trajtojnë shtetësinë kanë për qëllim të pamundësojnë paraqitjen e personave pa shtetësi (personat apatrid). Shtetësia zakonisht **parashihet me kushtetuta të shteteve** si e drejtë që i takon kategorisë së caktuar të individëve që jetojnë në shtet.

- ▶ Çështjet e **detajuara lidhur me shtetësinë rregullohen me ligjin** mbi shtetësinë të cilin e ka në një ose formë tjetër çdo shtet.
- ▶ Me ligjin për shtetësinë përcaktohet edhe parimi në bazë të cilit fitohet shtetësia:

**jus sanguinis** (e drejta e fituar në bazë të gjakut) ose **jus soli** (e drejta e fituar në bazë të vendit të lindjes).

#### 4.2 Liria e shteteve

Liria e shteteve përcaktohet nga Konventa e Hagës e 12 prillit 1930 “ me disa çështje lidhur me konfliktet e ligjit mbi shtetësinë ( që nuk është në fuqi në Francë). Nga kjo rezulton se asnjë shtet nuk mund t’i jep një personi shtetësinë e një shteti tjetër. Megjithatë kjo liri shtetërore njihet disa kufij.

#### 4.3 Konfliktet e shtetësisë

Si konflikte të shtetësisë janë :Konfliktet pozitive dhe konfliktet negative.

**a) Konflikti pozitiv i shtetësisë** është i shpeshtë. Konkretisht ai shfaqet kur vendi i origjinës i jep një personi shtetësinë e tij duke zbatuar sistemin jus sanguinis, ndërkohë që vendi pritës zbaton sistemin jus soli. Ai shfaqet edhe kur një person merr një shtetësi të re pa e humbur të parën psh. në rastin e martesës. Në praktikë shtetësia e dyfishtë paraqet avantazhe për të interesuarit dhe relativisht pak disavantazhe. Shtetet nuk i shikojnë me sy të mirë rastet e shtetësisë të cilat shkaktojnë vështirësi administrative dhe frikë për

unitetin kombëtarë, për këtë arsye disa tekste legislative i lejojnë të interesuarit të zgjedhë një opcion midis shumë shtetësive madje të shmangë shtetësinë e origjinës në rast se merr një shtetësi të re.<sup>38</sup> Megjithatë ka raste të veçanta kur konflikti i shtetësisë nuk zgjidhet në mënyre definitive dhe shumica e shtetësive përbëjnë problem. Të tilla janë rastet e proceseve administrative ose të mosmarrëveshjeve me palë një person me shtetësi të dyfishtë kur gjyqtari duhet të aplikojë një rregull konflikti, lidhja e së cilës është shtetësia. Ateherë duhet përcaktuar se cilën shtetësi duhet të marrë në konsideratë autoritetin që do të shqyrtojë mosmarrëveshjen.

Në të drejtën pozitive franceze zgjidhja bazohet në dallimin midis dy rastesh: rastet kur asnjëra prej shtetësive në konflikt është ajo franceze. Për këtë arsye jurisprudenca miraton një qëndrim pragmatik dhe shprehet në favor të zgjedhjes së shtetësisë më efektive. Kur në të kundërtën i interesuari ka shtetësi franceze, rregulla parashikon që ajo duhet të merret në konsideratë duke parashikuar që ajo duhet të merret në konsideratë duke përjashtuar çdo shtetësi tjetër. Në fakt ky parim që u afirmua në vendimin e 17 Qershorit 1968 nuk është vënë asnjëherë në dyshim.

Nga pikëpamja teorike parimi i përparësisë së shtetësisë së autoritetit që do të shqyrtojë çështjen do të mbështet në idenë sipas së cilës, meqenëse çdo legjislator është i vetmi autoriteti i vënë në lëvizje nuk mund të shmangë shtetësinë franceze të të interesuarit, qoftë ajo e zhveshur nga çdo vlefshmëri pa krijuar një rast humbje të shtetësisë franceze të parashikuar nga ligji. Kjo qasje në fakt është kundërshtuar nga partizanët e rregullores funksionale të konflikteve pozitive të shtetësive, sipas tyre parimi abstrakt i përparësisë së shtetësisë së autoritetit që do të shqyrtojë çështjen duhet zëvendësuar me kërkimin e funksionit që përmbush shtetësinë në rastin konkret dhe një gjë e tillë paraqet avantazhin për zgjidhjen e konfliktit dhe i përshtatet rethanave të situatës juridike.<sup>39</sup> Në rast që Gjykata e Kasacionit do të bazohet në përparësinë e shtetësisë franceze nuk ka dyshim që vendimi nuk do të ishte i njohur. Efektiviteti i Konventës franko-polake po shfaqet me ashpërsi, gjithsesi duket se e eardhmja e këtij vendimi është i kufizuar.

---

<sup>38</sup>Shih. Kodin Civil, neni 23-3

<sup>39</sup> E drejta ndërkombëtare private, Daniel Gutman, përkthye nga origjinali frëngjisht, Edmond Xhabija dhe Valbona Nano, Botimi i VI, 2009. fq. 337

Nga ana tjetër një doktrinë e rëndësishme konsideron se përgjithësimi i qasjes funksionale , do të vinte në dyshim unitetin e statusit të individit, barazinë midis francezëve, sigurinë juridike madje edhe identifikimin kombëtar. Debati nuk është kaq i fortë rreth konflikteve negative të shtetëve të cilat ndikojnë më pak drejtëpërdrejtë mbi kohëzisionin e shteteve.

### **b) Konfliktet negative të shtetësisë**

Konfliktet negative të shtetëve dërgojnë në mungesën e shtetësisë dhe pasigurinë që rrjedh prej saj, mungesë e mbrojtjes diplomatike, kërcnim për dëbim, pamundësi për të marrë pasaportë. Për këtë arsye Konventa e Kombeve të Bashkuara e 28 shtatorit 1954, tentoi të krijojë statusin e pashtetësisë duke u bazuar gjerësisht në Konventën e Gjenevës të 28 korrikut 1951 që aplikohet për refugjatët. Ajo njih disa të drejta dhe mbrojtje kundër dëbimit. Ajo ia nënshtron personit pa shtetësi, ligjin të vendbanimit të tij ose në mungesë vendbanimi, ligjin e vendqendrimit. Kriteret dhe kushtet e ndryshueshmëri që arashihen në të drejtat e shteteve konkret si për humbjen ashtuedhe për fitimin e shtetësisë, sjellin deri tek situatat që disa persona mbeten pa shtetësi. Secili shtet në mënyrë sovrane i përcakton me ligj kushte më të cilat fitohet dhe humbet shtetësia. Duke u nisur nga interesat e veta personale dhe specifike, shtetit i parashtrohen kushtet dhe mënyra të ndryshme për fitimin dhe humbjen e shtetësisë.

Për këtë arsye vjen deri tek konflikti i shtetëve. Në rastet kur personi nuk i plotëson kushtet e fitimit të shtetësisë sipas së drejtës së asnjë shteti, shtrohet çështja e konfliktit negativ të shtetësisë. Kurse, në rastet kur personi i plotëson kushtet për fitimin e shtetësisë sipas së drejtës së du apo më tëper shteteve. Këto situata sjellin deri tek paraqitja e personave pashtetësi dhe personat me dy ose më tepër shtetësi respektivisht deri tek konflikti negativ i shtetësisë dhe konflikti pozitiv i shtetësisë ngase nuk i plotësojnë kushtet për fitimin e shtetësisë sipas të drejtës së një shteti këta persona quhen apolid ose hajamatos. Për shkak të qasjeve të ndryshme të marra nga shtetet në lidhje me fitimin dhe humbjen e shtetësisë, disa individë vazhdojnë të “bien në situata ngërçesh ligjore” dhe kthehen në persona pa shtetësi.

Rregullat e përbashkëta për këtë arsye janë thelbësore për të adresuar boshllëqe të tilla. Në vitin 1950, Komisioni për Ligjin Ndërkombëtar (KLN) filloi procesin e hartimit të asaj që më vonë do të shfaqej si Konventa e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë (Konventa e Pashtetësisë së vitit 1961). Konventa e vitit 1961 është i vetmi instrument universal që zhvillon dhe ofron masa të qarta, të hollësishme dhe konkrete për të siguruar një përgjigje të drejtë dhe të përshtatshme ndaj kërcënimit të pashtetësisë. Nenet e Konventës së vitit 1961 synojnë të shmangin pashtetësinë në lindje dhe në faza të mëvonshme në jetë, por ata as nuk ndalojnë mundësinë e heqjes së shtetësisë në rrethana të caktuara, e as u kërkojnë Shteteve t'u japin shtetësinë të gjithë personave që aktualisht janë pa shtetësi.<sup>40</sup> Konventa e vitit 1961 gjithashtu parashikon krijimin e një organi në të cilin personat të cilët mund të përfitojnë nga dispozitat e Konventës së vitit 1961 të mund të aplikojnë që kërkesa e tyre të vlerësohet si edhe të kërkojnë ndihmë në paraqitjen e kërkesës tek autoriteti i duhur. Në vijim Asambleja e Përgjithshme i kërkoi UNHCR-së ta përmbushë këtë rol. (Shih Shtojcën 2 për një listë të Shteteve Palë të Konventës së vitit 1961.)

Në përpjekje për të reduktuar rastet e shumta të pashtetësisë, Konventa e vitit 1961 kërkon që shtetet palë të rregullojnë legjislacionin mbi shtetësinë që reflekton standardet e përshkruara në lidhje me fitimin ose humbjen e shtetësisë. Në rast lindje të mosmarrëveshjeve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës mes shteteve kontraktuese, e pamundësisë për t'i zgjidhur ato me mjete të tjera, shtetet mund t'i drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e çdo njëjës prej palëve në mosmarrëveshje.

Pavarësisht përpjekjeve për reduktimin e shpeshtë të pashtetësisë me anë të ligjeve kombëtare mbi shtetësinë dheme anë të implementimit të Konventës së vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë dhe instrumente të tjera ndërkombëtare, UNHCR-ja vlerëson se ka miliona njerëz në botë që nuk kanë shtetësi.

Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa shtetësi përcakton se cili është person pa shtetësi, promovon fitimin e identitetit ligjor për

---

<sup>40</sup> Shtetësia dhe pashtetësia, doracak për parlamentarët nr.22, Bashkiomi ndërparlamenta për demokraci për të gjithë, UNHCR, 1989, fq.17



ata persona dhe siguron që personat pa shtetësi të gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore pa diskriminim. Jo më pak se rëndësia e shtetësisë është çështja e konfliktit të shtetësisë. Pikërisht edhe pse teoria dhe praktika kanë përcatur parime për marrjen e shtetësisë kjo do të thotë se nuk mund të vije deri tek konflikti i shtetësisë.

#### 4.4 Personat me disa shtetësi

Personat me shumë shtetësi janë ata persona që njëkohësisht janë lidhur juridikisht me sovranitetin personal të dy ose më tepër shteteve. Egzistimin paralel i dy sistemeve kryesore për fitimin e shtetësisë ius sanguinis dhe ius soli, si pasojë e interesave të ndryshme të shteteve të emigracionit dhe imigracionet, shkakton paraqitjen e personave me dy shtetësi. Populli si dukuri shoqërore është kategori historike, domethënë ka zënë fill në një fazë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë. Në radhë të parë ai është rezultat i domosdoshëm i shkallës së caktuar të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik. Populli është krijesë historike që shfaqet gjatë ngjarjeve shoqërore të cilat i shkakton rrënja e bashkësive të hershme dhe shfaqja e kategorive të reja shoqërore. Popujt pra janë tërësi shoqërore-etnologjike që përbëjnë në pikëpamje të zhvilluar ose pak të zhvilluar, gati të gjitha elementet e kombit të ardhshëm, ashtu si janë uniteti i territorit dhe i gjuhës, si dhe lidhshmëria politike dhe ekonomike.

Populli karakterizohet prej ngjashmërisë së jetës, afërisë së dialekteve dhe dokeve, e kaluara e përbashkët historike, traditat e tjera.<sup>41</sup> Populli pra paraqet një lidhje të njerëzve në bazë të disa karakteristikave të përbashkëta që i dallojnë prej të tjerëve siç janë gjuha, historia, kultura, doket, zakonet, kompaktësia territoriale dhe lidhjet politike. Në gjysmën e dytë, veçmas në fund të qindvjetëshit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të qindvjetëshit të kaluar vjen deri te shfaqja e kombeve të reja. Ligjësitë në zhvillimin e kombeve janë shfaqur në mënyra të ndryshme gjatë zhvillimit të çdo kombi.

---

<sup>41</sup> Ramadan Bajrami, Fillet e së drejtës, viti i I-rë, Januar, 2013, fq.65

Lidhur me kombin egzistojne teori të ndryshme, vetë termin komb për herë të parë e ka përdorur De Stal, në vitin 1810 ndërsa kombi ka hyrë në përdorim në vitin 1835 në Dictionaire Academique. Kombi historikisht është i kushtëzuar me sintezën e faktorëve territorialë dhe shoqërorë-ekonomik dhe prej elementeve të tjera kulturore, gjuhësore, etnike dhe veçorive të tjera. Pra kombi ka edhe formën më të lartë të oragnizimit politik dhe territorialë shtetin, dhe këto njihen si shtet-kombe, ndërsa populli mund që ti ketë këto krarakteristika por mund të gjendet në ndonjë shtet tjetër dhe së bashku me popujt e tjerë apo ndonjë popull tjetër të përbëjë ndonjë shtet të caktuar. Mirëpo, brenda një shteti jetojnë qytetarë të ndryshëm, andaj egziston domosdoshmëria e grupimit të tyre, domethënë, e klasifikimit të tyre në qytetarë vendorë dhe në qytetarë të jashtëm.

Qytetarët vendorë kanë të drejta dhe detyrime të caktuara sipas normave juridike dhe si të këtyllë kanë të drejtë të ushtrojnë shërbime publike, dhe funksione shtetërore, duke zbatuar të drejtën e shtetit përkatës, domethënë të shtetit që i përkasin. Nga kjo del se nocioni i shtetësisë paraqet: **LIDHJE JURIDIKE TË QYTETARIT ME SHTETIN**. Qytetarët të cilët gëzojnë të drejta dhe detyrime dhe i nënshtrohen juridiksionit shtetëror quhen SHTETAS, ndërsa qytetarët të cilët gëzojnë të drejta private-civile dhe gëzojnë imunitet personal, jo edhe autorizime dhe obligime të tjera janë qytetarë JOSHTETAS.

Shtetësi e shumëfishtë, shumështetësia është situata ku një person njihet njëkohësisht si shtetas i ligjshëm i më shumë se një shteti. Shtetësia e shumëfishtë egziston pasi shtete të ndryshme përdorin përkufizime të ndryshme të shtetësisë që nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Paçka shprehjes "të kesh dy (disa) shtetësi", nga ana ligjore janë shtetet që deklarojnë (njohin) personat si shtetas. Rrjedhimisht një njeri mund të jetë shtetas i një, shumë ose asnjë shteti. Çdo shtet sovran ka të drejtë të vendosë kushtet dhe politikat si për ta marrë shtetësinë e tij, ashtu dhe për ta mbajtur.

Meqenëse zakonisht nuk ka institucione që t'i bashkërendojë ligjet e vendeve sovrane mbi shtetësinë, një person mund të fitojë një shtetësi pa humbur shtetësinë e mëparshme, ose t'u përmbahet përkufizimeve të më shumë se një shteti, duke përfituar njëkohësisht më shumë se një shtetësi. Disa nga arsyet më të zakonshme janë :

Jus Sanguinis - të paktën njëri nga prindërit është shtetas. Shumica e anëtarëve të OKB njohin jus sanguinis si kusht të mjaftueshëm për shtetësi automatike edhe vetëm nga njëri prind.

Jus Soli - lindja në territorin e shtetit. Kjo praktikë është e zakonshme në kontinentin amerikan, por shumë e rrallë tjetërkund (vetëm Pakistani, Lesoto, Fixhi dhe Tuvalu e praktikojnë jashtë amerikave).<sup>42</sup>

Jus Matrimonii - martesë me një shtetas. Zakonisht martesë thjeshtë shkurton kohën e natyralizimit, por në disa raste jep shtetësi të menjëhershme. Ky është rasti në disa shtete islamike; kur një grua martohet, merr shtetësinë e burrit automatikisht (p.sh. në Iran).<sup>43</sup>

Natyralizimi - ligjet dhe kërkesat mund të ndryshojnë shumë (p.sh. 3 vjet rezidencë në Belgji, 30 vjet në San Marino).

Adoptim - persona nën 18 që adoptohen nga shtetas.<sup>44</sup>

Merita - disa shtete japin shtetësi të menjëhershme për disa profesione (p.sh. Austri për profesorë universitarë të thirrur nga universitetet Austriake). E përhapur është edhe praktika e dhënies së shtetësisë honorare për kontribute ndaj njerëzimit.

Investim - Disa shtete garantojnë shtetësi të menjëhershme nëse bëhet një investim i rëndësishëm në favor të shtetit (zakonisht shuma të mëdha)

Fe - Ligji i Kthimit në Izrael u jep shtetësinë gjithë hebrenjve që mund të vërtetojnë përkatësinë etnike ose fenë e tyre dhe emigrojnë në Izrael.

Jus Oficii - Ky është një rast i veçantë (dhe tejet i rrallë) ku shtetësia "caktohet" për këdo zhvillon një funksion të përcaktuar. Zakonisht edhe tërhiqet sapo mbaron marrëdhënia punësore. Shembull tipik i kësaj praktike është Vatikani, që u jep shtetësi të gjithë atyre që

---

<sup>42</sup>Konventa për Uljen e Rasteve të Shtetësisë së Shumëfishtë dhe Detyrimeve Ushtarake në Rast Shumështetësie, 1963, 28/03/1968, pjesa e dytë, raste me shtetësi të dyfishtë, fq.8

<sup>43</sup> Analiza e zbatimit të Direktivës 2004/80 Ec lidhur me viktimat e krimit, Komisioni Europian, Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë, Raport Syntetik, 12 Dhjetor, 2008, fq.40

<sup>44</sup>Konventa për Uljen e Rasteve të Shtetësisë së Shumëfishtë dhe Detyrimeve Ushtarake në Rast Shumështetësie, 1963 28/03/1968, pjesa e dytë, raste me shtetësi të dyfishtë, fq.8

punëson brenda shtetit (0.44 km<sup>2</sup>). Diçka e ngjashme mund të ndodh edhe me Bashkë-Princat e Andorrës:

Presidenti francez dhe Peshkopi i Urgjellit, Spanjë. Jo të gjitha shtetet japin mundësinë të heqësh dorë nga shtetësia e tyre. Shtetet që vendosin si kusht për natyralizim dorëheqjen nga shtetësitë e mëparshme, mund të kërkojnë një dorëheqje zyrtare. Kur individi i natyralizuar vjen nga një shtet që nuk parashikon dorëheqjen e shtetësisë, i mban dyja pavarësisht zgjedhjes së tij për ta lënë të parën. Në rastet kur shtete të ndryshme kanë pretendime sovraniteti për të njëjtin territor, banorët e atij territori zakonisht konsiderohen shtetas të të dyja subjekteve. Tajvani dhe Kina, duke mos njohur autoritetin e qeverisë së ndërsjellët, trajtojnë ligjërisht të gjithë kinezët si shtetas të secilës (megjithatë, Tajvani nuk u jep të drejtë të zhvendosen në shtet banorëve të Republikës Popullore për arsye logjistike). Qeveria e Qipros konsideron shtetas banorët e gjithë ishullit, por gjysma veriore (me shumicë etnike turke) ka shpallur pavarësinë dhe u jep qytetarëve të vet një shtetësi më vete. Meqenëse shtetësia vlen vetëm kur njihet sovraniteti i një shteti, në këtë rast kjo shtetësi njihet vetëm nga Turqia.

#### 4.5 Evidenca e shtetasve dhe lëshimi i çertifikates të shtetësisë

Ndërsa evidenca e shtetasve udhëhiqet në librin amë të të lindurve sipas rregullave për udhëheqjen e këtij punimi. Evidenca e shtetasve maqedonas të cilët jetojnë përherë në vendet e huaja udhëhiqet nga përfaqësittanë diplomatik ose konsullure. Gjatë regjistrimi të lindjen në librin amë të të lindurve të dhënat e shtetësisë regjistrohen në rubrike "shtetësi" ndërsa ndryshimet plotësuese të shtetësisë regjistrohen në rubrikë " Regjstrime plotësuese dhe shënim". Kështu për shëmbull kur regjistrohe lindja e personit shtetas i Republikës së Maqedonisë në rubrikën " Shtetësia", regjistrohet i tërë emri kushtetues i shtetit : " Republika e Maqedonisë së Veriut".

Në qoftë se regjistrohet i huaji në rubrikën e përshtatshme regjistrohet shtetësia e huaj e personit dhe prindërve të tij, dokumenti në bazë të së cilës është bërë regjistrimi

organi i cili ka dhënë, munrin dhe datën e lëshimit. Shtetësia dëshmohet me leternjoftim ose pasaportë për shtetin tonë. Në qoftë se personi nuk ka asnjë nga këto dokumente për të dëshmuar shtetësinë atë do të mund të dëshmojë me certifikatën e shtetësisë të lëshuar nga organi kompetent në bazë të evidencës për shtetasit e Maqedonisë. Evidenca e shtetasve udhiqej në libra të posaçëm të shtetësisë dhe në bazë për të dhënat të saj është lëshuar certifikatat e shtetësisë dhe atë për personat për të cilat në librat amë nuk është regjistruar e dhënë për shtetësinë respektivisht për personat e lindur deri sa udhëhiqeshin libra të posaçëm për shtetësinë

#### **4.6 Shtetësia si fakt vendimtarë (në mardhëniet statusore)**

Shtetësia nuk paraqet tek të gjitha marrëdhëniet juridike-private me elemente të huaj si fakt vendimtarë por vetëm te kategoritë e caktuara të marrëdhënieve juridiko-private. Marrëdhëniët kur shtetësia paraqitet si fakt vendimtarë ( pikë e lidhjes) janë marrëdhëniet statusore dhe trashëgimore. Por megjithse shtetësia nuk është pranuar tek të gjithë shtete si fakt i tillë. Vetëm tek shtetet e emigracionit shtetësia shërben si fakt vendimtarëngase shtetet e imigracionit siç do të shohim më vonë aplikojnë fakte tjera vendimtare. Deri kah fund i shekulli XVII, ekskluzivisht si fakt vendimtarë është aplikuar vendbanimi. Aplikimi i shtetësisë si fakt vendimtarë për regulimin e mardhënieve statusore me element të huaj në teori arsyetohet me faktin se shtetësia është lidhje midis personit fizik dhe shtetit konkret që i mundëson personi një status të caktuar.

Në qoftë se respektohet sovraniteti shteteve këtë status të subjektit mund ta ndryshojë vetëm ai sovranitete që ia ka dhënë subjektit.<sup>45</sup>Vlen që të përmendim se përcaktimi i fakteve vendimtare që do të ndikojë te rregullimi i marrëdhënieve statusore është me rëndësi të veçantë për shtetet e emigracionit ngase nuk është njësoj se a do të aplikohet e drejta e rregullimit të kësaj materie.

Kështu për shembull te zotësia juridike mosha madhore dukshëm ndryshon ngase në disa shtete ajo fitohet me 18 vite moshë në disa me 21, kurse në të tjerat me 25 vite.

---

<sup>45</sup> Arben Puto, E drejta ndërkombëtare publike, Albin, 2008, f.278

Gjithashtu dallimet të mëdha egzistojnë në lëgjislicionet e shteteve të ndryshme në fushën e marrëdhënieve familjare. Marrëdhëniet statusore me element të huaj nënkuptojnë mundësinë që personi i huaj në territorin e shteteit të vendit ose shtetasi i vendit në territorin e shtetit të huaj të krjojë marrëdhënie konkrete statusore, si për shëmbull të lidhë martesë, adoptim, legjitim, kujdestari, etj. Në qoftë se njëri prej elementet e marrëdhënies është i shprehur si i huaj. Që një marrëdhënie e këtillë statusore të prodhojë efekte juridike, në territorin e shtetit të vendit duhet që të huajit ti mundësojë paraprakisht gëzimin e të drejtave statusore dhe ajo marrëdhënie të mos ketë rrënë në kontakt të drejtëpërdrejtë me organin e sovranitetit të huaj atëherë ajo marrëdhënie në territorin e shtetit të vendit do të njihet si marrëdhënie statusore me element të huaj, dhe do të prodhojë efekte juridike në qoftë se është në harmoni me normat e shtetit mbi kolezionin e juridiksioneve. Për këtë arsye kur thuhet se shtetësia paraqitet si fakt vendimtarë mendohet në rolin e shtetësisë në tre drejtime edhe atë: si fakt vendimtarë lidhur me gëzimin ushtrimin e së drejtës së huaj ose të drejtës së shtetit të vendit dhe si fakt vendimtarë për caktimin e kompetencës së gjykatës së shtetit të vendit ose gjykatës së huaj. Lidhur me gëzimin e të drejtave statusore shtetësia paraqitet si fakt vendimtar kryesisht në këto raste kur shtetasi i huaj duhet të gëzojë ndonjë të drejtë statusore ndaj shtetatsit të vendit. Respektivisht në këto raste elementi i huaj në subjekt shfaqet si i përzier ngase shtetasi i huaj në territorin e shtetit të vendit ushtron të drejta statusore ndaj shtetasve të vendit, varësisht nga lloji dhe kategoria e të drejtave statusore ndaj shtetasve të huaj.

Të drejtat statusore të të huajve në shtetin e vendit për nga mundësia e gëzimit në shtetet e ndryshme trajtohen në mënyra të ndryshme. Kështu për shëmbull në disa shtete të drejtat e të huajve në martesë, adoptim, legjitim etj. trajtohen si të drejta absolutisht të rezervuara në shtete e tjera si të drejta relativisht të rezervuara kurse në shtete e treta si të drejta të përgjithshme. Si fakte të indentifikimit (fakte në bazë të të cilave krijohet elementi i huaj juridiko-privat) në subjekt, pra, shtetësia, vendbanimi(domicile) dhe përkatësia e personave juridik mund të paraqiten te të gjitha kategoritë juridiko-private me element të huaj, edhe të marrëdhënieve detyrimore me element të huaj. Mjafton të konstatohet se personi i cili merr pjesë në cilën do qoftë marrëdhënie juridiko-private, nuk

ka vendbanim në territorin e shtetit të vendit ose nuk është shtetas i vendit, ose në qoftë se është person juridik nuk e ka përkatësinë e shtetit të vendit, që të konstatohet marrëdhënia në fjalë nuk rregullohet me dispozitat (normat) e së drejtës (të sistemit juridik) së brendshme por itakon lëmisësë rregullimit të së drejtës ndërkombëtare private. Po ashtu vlen që të përmendim së në Republikën e Maqedonisë, është miratuar ligji, për të drejtën ndërkombëtare private ku me anë të këtij ligji, rregullohet përcaktimi i të drejtës personale (statusin, familjen, punën, pasurinë dhe materiale të tjera). Ky ligj rregullon marrëdhëniet juridike me element ndërkombëtar.

Ky ligj gjithashtu përmban rregulla mbi jurisdiksionin e gjykatave dhe organeve të tjera të Republikës së Maqedonisë, këtu kemi trajtimin e marrëdhënieve nga paragrafi i 1 i këtij neni, rregullat e procedurës dhe rregullat e procedurës dhe rregullat e njohjes së vendimeve të gjykatave të huaja dhe vendimet e organeve të tjera të një vendi të huaj.

#### **4.7 Shtetësia si fakt vendimtarë (në marrëdhëniet trashëgimore)**

Roli i pikave të lidhjes konsiston në përcaktimin e rendit juridik konkret, normat juridike të cilat zbatohen për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-private me element të huaj dhe përcaktojnë se të drejtat në shtetin e vendit a do të jenë kompetent Gjykata e shtetit të vendit apo e shtetit të huaj, bëjnë shmangie nga zbatimi i ligjit nacional dhe nga kompetencat e Gjykatës Nacionale të personit për statusin e të cilit shtrohet në tre raste, rasti i parë është proteksionizmi nacional, rasti i dytë bëhet për shkak të masave të përkohshme, rasti i tretë bëhet për shkaqe humane. Roli i shtetësisë si fakt vendimtar në marrëdhëniet trashëgimore përshkruan të gjitha ato marrëdhënie trashëgimore dhe konsistonnë përcaktimin dhe përgjigjen në pyetjen se shtetasi i huaj a mund të trashëgojë, sipas cilës së drejtë do të shqyrtohet trashëgimia a do të jetë kompetente Gjykata e shtetit të vendit apo Gjykata e huaj.

Egzistojnë dy sisteme si fakte vendimare për të drejtën kompetente sipas së cilës do të çelet trashëgimia e de cujusit sipas sistemit të parë – në tërëtrashëgimin dhe te

trashëgimia që ka për objek sendet e paluajtshme dhe të luajtshme zbatohet Ligji Nacional i trashëgimilënësit sepse në sistemin juridik të këtyre shteteve tërëtrashëgimia trajtohet si e njësuar dhe si fakt vendimtarë merret shtetësia e trashëgimtarit sipas sistemit të dytë – zbatohet ligji i shtetit ku ndodhet masa trashëgimore e paluajtshme lex rei sitae kurse trashëgimia e pasurisë së luajtshme zbatohet e drejta e shtetësisë lex nationaltis sëtrashëgimilënësit (de cujusit).

Rregullorja Nr.650/2012 i vendos gjykimet e çështjeve gjyqësore ose jo gjyqësore nën jurisdikcionin e gjykatës kompetente mbi bazën e lidhjeve reale mes marrëdhënies trashëgimore dhe territorit të një shteti anëtar duke marrë parasysh jo vetëm respektimin e veçantisë së një çështjetë caktuar trashëgimore (në të cilën ndërhyrja e gjykatës është shpeshherë jo e vetmja zgjidhje për arritjen e rezultateve të parashikuara nga ligji në planin kombëtar).

Në kuadër të të gjithë objektivave që rregullorja përmban, vihet re se në të shfaqet edhe ajo tentativë e cila synon të përcaktojë jurisdikcionin përkatës, kompetent për të gjykuar marrëdhënien trashëgimore, mënyrë të cilën e realizon duke marrë parasysh thuajse të gjitha karakteristikat e marrëdhënies trashëgimore në fjalë (për shembull rasti i “zhvendosjes së një personi nga njëri shtet anëtar në shtetin tjetër qoftë si shkak i marrëdhënieve personale apo atyre profesionale por që në momentin e vdekjes lë pasuri të tijën në njërin nga shtetet e sipërpërmendur). Trashëgimi përbën një ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës dhe kjo për faktin jo vetëm se është një marrëdhënie juridike e cila has zbatimin më të shpeshtë dhe të vazhdueshëm në praktikë, por ajo çka është më e rëndësishme për këtë institut vjen si pasojë objektit të këtij instituti, i cili ka të bëjë me kalimin apo transferimin e të drejtave dhe detyrimeve vetëm si pasojë e vdekjes së titullarit i cili ishte mbartës i këtyre të drejtave dhe detyrimeve pasurore.<sup>46</sup>

---

<sup>46</sup>Si pasojë e vdekjes shuhen të drejtat dhe detyrimet jo pasurore dhe të drejtat e personalitetit, ckaa do të thotë se me vdekjen e titullarit të këtyre të drejtave, ato nuk transferohen apo nuk trashëgohen tek trashëgimtarët. Këto të drejta për shembull mund të jenë: të drejtat dhe detyrimet familjare që lidhen ngushtësisht me pozicionin e veçantë që personi ka në familje apo për rsatin e të drejtave të personalitetit: e drejta autorit etj. Nga ana tjetër, duke u bazuar në parimin e përgjithëm, të drejtat pasurore absolute të të vdekurit, apo pronësia dhe të drejtat e tjera reale të gëzimit apo garancitë reale o të transferohen tek trashëgimtarët përveç rasteve kur këto të drejta për shkak të thelbit ë tyre nuk mund të zgjasin përtej jetës së personit që i mbarte keto të drejta, për shembull: uzufuktit, përdorimi etj. Në



Vendimet në çështjet e trashëgimisë, që burojnë nga një shtet anëtar do të zbatohen në një shtet tjetër anëtar, pasi të jenë aprovuar në shtetin e origjinës. Siç u cek më lartë kërkesa për ekzekutimin duhet t'i paraqitet autoriteteve juridike përkatëse të çdo shteti dhe më pas t'i komunikohet Komisionit Evropian sipas nenit 78 të Rregullores Nr.650/2012. Kompetenca territoriale e gjykatës të vendit në të cilin ndodhet vendqëndrimi i palës kundrejt së cilës është kërkuar ekzekutimi, ose gjykatës të shtetit në të cilin vendimi do të ekzekutohet. Sipas asaj që është vendosur në Nenin 46 të Rregullores Nr.650/2012, format e procedimit janë të disiplinuar nga ligji procedural në shtetin ku kërkohet ekzekutimi i vendimit. Legjislatori evropian kufizohet të përmendë që cilado qoftë procedura e aplikuar nga shteti ekzekutues, ajo duhet të trajtojë në mënyrë të barabartë palët. Gjithashtu sqarohet se pala që kërkon vënien në ekzekutim të vendimit nuk është e detyruar të paraqesë një adresë ose ndonjë tjetër mënyrë komunikimi me gjykatën. Pavarësisht kësaj, përderisa thuhet në të gjithë territorin e Bashkimit Evropian kërkesa për ekzekutimin e vendimit të huaj bëhet nga pala kërkuese nëpërmjet një avokati apo përfaqësuesi ligjor, mbetet njëfarë garancioni ose pikë referimi përsa i përket komunikimit midis gjykatës dhe palës.

Kërkesës për ekzekutimin e vendimit duhet ti bashkëngjiten në mënyrë të detyrueshme këto dokumente:

a) një kopje e vendimit që përmbush kushtet e nevojshme për të përcaktuar originalitetin e saj dhe

b) certifikata që ka lëshuar organi juridiksional apo autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, duke përdorur formë e kërkuar sipas procedurës këshilluese që parashikohet në Nenin 81, paragrafi i dytë i Rregullores Nr.650/2012. Arsye që justifikojnë krijimin e një certifikate evropiane të trashëgimisë janë të shumta. Nga njëra anë qëndron tek lëvizja e lirë e personave, e cila i nxit individët për blerjen e të mirave materiale (për nevojën e të jetuarit, për nevojën e të punuarit ose biznesit, për investim, apo për pushime

---

këtë kontekst dhe duke u bazuar mbi atë më sipër, mund të thuhet se do të transferohen trashëgimtarëve jo vetëm të drejtat por edhe detyrimet që gëzonte titullari dhe nuk do të ketë transferim të tyre vetëm në rast se ato janë ngushtësisht të lidhura me personin që i gëzonte

turistike) në Shtete të ndryshme nga ai në të cilin ata janë qytetarë, por edhe nga ai Shtet në të cilin ata kanë vendqëndrimin e zakonshëm.

Ndërsa, nga ana tjetër, qëndron shpeshtësia më të cilën paraqiten forma të njëjta të zgjidhjes së çështjeve trashëgimore, si për shembull trashëgimia përshkak vdekjeje, marrëdhënie kjo e cilashpesh disiplinohet përmes një ligji të vetëm (që mund të jetë ai i shtetësisë, i vendqëndrimit, apo ligji i zgjedhur nga trashëgimlënësi), në mënyrë të pavarur nga vendndodhja e rasteve që përbëjnë pasurinë (vetëm në disa sisteme juridike si për shembull ai francez dhe anglez, do të përbëjnë kriterin mbizotërues të lidhjes që konsiston në zgjedhjen e ligjit të vendit në të cilin ndodhen të mirat e luajtshme ose të paluajtshme “lex rei sitae”).<sup>47</sup>Rregullorja Nr.650/2012, në pritje të shumëllojshmërisë të vizioneve dhe instrumenteve që gjenden tek e drejta e brendshme e vendeveanëtare (për të harmonizuar rregullat e konfliktit në çështjen e trashëgimisë) zgjeron disiplinën uniforme edhe tek paktet testamentare, por kjo ndodh vetëm përsa kohë këto pakte janë të kualifikuara siç duhet (si një dispozitë për shkak vdekjeje) përkrah testamentit apo testamentit të përbashkët.

Nga ana tjetër, Rregullorja Nr.650/ 2012 përjashton nga fusha e aplikimit mjetet e tjera (për më shumë ato të natyrës kontraktuale), duke mos njohur arsye për t'i hequr ato tërësisht nga disiplina përkatëse dhe në të shumtën e rasteve kjo disiplinë tentohet që të jetë uniforme, e njëjtë për detyrimet kontraktuale. Megjithatë, vlerësimin mbi ligjshmërinë e marrëveshjevekontraktuale midis palëve, rregullorja ialënë dorë ligjit të aplikueshëm. Nga Nr. 49 i rregullores (recital) del se synimi kryesor për të lehtësuar njohjen dhe njehsimine të drejtave trashëgimore në shtetet anëtare, duhet që këto të drejta trashëgimore të fitohen sipasojë e një pakti trashëgimor, i pranuar dhe konsideruar i vlefshëm nga ligji i aplikueshëm konform normave të konfliktit të njëtrajtshëm, të vendosura nga Nenet 25, 26 dhe 27 të Rregullores. Në këtë mënyrë evitohet që të drejtat e lindura nga pakti të mos bien ndesh me zbatimin e normave të aplikimit të nevojshëm, apo të parimeve të rendit publik të “lex fori-it”.

Duke minimizuar pasigurinë e vlefshmërisë në nivel ndërkombëtar të pakteve trashëgimore, mund të thuhet me bindje se disiplina e re evropiane ka efekt lehtësues në

---

<sup>47</sup> Disertacioni i doktoraturës, Trashëgimia në të drejtën ndërkombëtare private, Laura Vorpsi, Tiranë, 2015, fq.100

përdorimin e këtij mjeti juridik dhe kjo ndodh nëse bëhet fjalë për hamendësime, në të cilat paktet pranohen nga të paktën një ligj abstrakt që aplikohet për trashëgiminë. Një gjë e tillë përforcon vullnetin e individëve në mënyrë që të planifikojnë trashëgiminë e tyre sipas dëshirës së tyre dhe përmes një pluraliteti të ndryshëm sistemesh juridike. Nga ana tjetër, për të lehtësuar interpretimin e njëtrajtshëm të aktit normativ evropian dhe për t'i dhënë një përkufizim termave juridikë të përdorur në të, rezulton se shfrytëzohen nocionet autonome (në kuadër të Neni 3 të Rregullores)<sup>48</sup> gjyqësor evropian në lidhje me aktet trashëgimore.

---

<sup>48</sup>Çertifikata Europiane për trashëgimi, 650/2012, Parlamenti Evropian dhe Këshili i Juridiksionit, zbatim i ligjit mbi njohjen e zbatimit të vendimeve dhe pranimin e instrumenteve autentike në çështjen e trashëgimisë. The Regulation (EU) No 650/2012 of the European Parliament and of the Council of 4 July 2012 on jurisdiction, applicable law, recognition and enforcement of decisions and acceptance and enforcement of authentic instruments in matters of succession and on the creation of a European Certificate of Succession (hereinafter referred to as the "Succession Regulation"). ( Disertacioni i doktoraturës Laura Vopsi, Trashëgimia në të drejtën ndërkombëtare private, Tiranë, fq.98

## KAPITULLI V

### 5. Humbja e shtetësisë

Humbja e shtetësisë me heqje dore si institut juridik nuk është i njohur në të gjitha shtetet. E në ato shtete ku zbatohet mënyra e humbjes së shtetësisë me heqje dore është e lidhur në një farë mënyre me mënyrat plotësuese të fitimit të shtetësisë si p.sh natyralizëm, lidhja e martesës, lindja në territorin e shteteit të caktuar etj që do të thotë më fjalë të tjera se në këto shtete heqja dore nga shtetësia nuk i lejohet secilit shtetas. Shtetësia si lidhje karakterit juridiko-politik midis sovranitetit të shtetit konkret dhe personit fizik ka karakter të përhershëm nga lindja e deri në vdekje. Por në qoftë se për shkaqe të ndryshme vije deri te ndërprerja faktike e lidhjes së interesave midis shteteit dhe personit fizik nën kushtet e caktuara me ligj të shtetit shtetësinë e të cilit e ka personi konkret, atëherë mund të humbet shtetësia. Kjo do të thotë se shtetësia mund të humbet me vdekjen e personit fizik ose derisa personi fizik është i gjallë me vendim të organit të shteteit konkret. Kur shtetësia humbet për shkak të vdekjes së personit fizik krijohen efekte juridike edhe ndaj anëtarëve të familjes së tij. Pasi mënyrat e fitimit dhe të humbjes së shtetësisë janë kometencë ekskluzive të shteteve secili shtet varësisht nga interesat e veta i parasheh me të drejtën e vetë pozitive mënyra e humbjes së shtetësisë.

Vdekja e personit fizik, si mënyrë e pushimit të shtetësisë është e parapar në të gjitha sistemet juridike të shteteve në botë, kurse mënyra e pushimit të shtetësisë deri sa është gjallë një person pra, me vendim të organit të shtetit konkret, ndryshojnë prej shtetit në shtet. Në sistemet juridike të shteteve bashkëshortore si mënyra e humbjes së shtetësisë janë: heqja dorë nga shtetësia, lënia e shtetësisë, marrja, mungesa, martesë me shtetas të huaj, shkurorëzimi i martesës, legjitimimi nga ana e shtetasve të huaj, adpotimi nga i huaji, natyralizmi, ndryshimi i sovranitetit të shteteit sipas traktateve ndërkombëtare etj. Të gjitha mënyrat e theksuar më sipër të humbjes së shtetësisë mund të klasifikohen në tri grupe varësisht sipas së cilit kritet bëhet klasifikimi.

Në qoftë se merret për bazë kriteri bëhet klasifikimi.<sup>49</sup> Në qoftë se merret për baze kriteri për shkak të mospërbushjes së detyrimeve të shtetasve ndaj shtetit dallohen: mungimi dhe heqja e shtetësisë. Në qoftë se merret për bazë humbja e shtetësisë për shkak të shprehjes së vullnetit së individëve i cili më anë të kërkesës me shkrim kërkon që të ndryshojë shtetësinë dallohen: dalja nga shtetësia dhe heqja dorë nga shtetësia.

Si grup i veçantë i humbjes së shtetësisë mund të trajtohet edhe humbja shtetësisë për shkak të pozitës së pabarabartë juridike të gjinive. Siç u tha më lartë më sipër në sistemet juridike të shteteve të ndryshme, heqja dorë dhe sipas traktateve ndërkombëtarë. Kështu, për shembull sipas legjislacionit Shqiptarë, Dekreti i Korrikut, v.1998 nën nenin 15 përcaktohet se: “Shtetësia shqipëtare merr fund me kërkesën e personit me lejen e shtetësisë dhe sipas traktateve ndërkombëtare”. Shtetësia me marrje humbet sipas vendimit të organit kompeten në raste kur shtetas i shtetit të vendi duke ushtruar vendime aktive merr qëndrime jo lojale ndaj shtetit të vendit. Andaj secili shtete në mënyrë individuale cakton se cilat veprimet aktive ndikojnë që organi kompetent të lëshojë vendimi për marrjen e shtetësisë andaj klasifikimi i veprimeve aktive dallohet në shtete e ndryshme.<sup>50</sup>

### **5.1 Humbja e shtetësisë për shkak të shprehjes së vullnetit - dëshirës**

Mënyrat e humbjes së shtetësisë për shkak të mos përbushjes së detyrimeve të shtetasit ndaj shtetit janë: marrja e shtetësisë dhe mungimi nga shtetei.

- a) Humbja e shtetësisë me dalje nga shtetësia: për shkaqe të ndryshme shtetasi i një shteti konkret mund të ndërpresë lidhjen faktike me shtetin shtetas i cili është dhe krijon lidhje të asaj mënyre, madje edhe mund të fitojë shtetësinë e shtetit tjetër. Në

---

<sup>49</sup> Asllan Bilalli, Hajredin Kuçi, E drejta ndërkombëtare private, Tetovë, 2008, fq.196  
Asllan Billali ,Hajredin KUQI E drejta Nëdrekombetare Private

këto grupe shtetesh lejohet dalja nga shtetësia me automatizëm respektivisht nëqoftë se janë plotësuar kushtet e parapara me ligjin e shtetit shtetas.

- b) Humbja e shtetësisë me heqje dorë: humbja e shtetësisë me heqje dorë si institut juridik nuk është i njohur në shumë shtete, në këto shtete ku është i njohur ku heqje dorështë lidhur ngushtë me mënyrat plotësuese të fitimi të shtetësisë. Këtë mënyrë të humbjes së shtetësië me heqje dorë e shohim tek Dekreiti i Korrikut i vitit 1998 të Republikës së Shqipërisë, Ligjin e shtetësisë në Republikën e Kroacisë. Veçmas humbjes së shtetësisë për shkak të shprehjes së vullnetit të lirë kemi edhe humbjen e shtetësisë për shkak të mungimi. Mungimi përkufizohet si mënyrë e humbjes së shtetësië së cilës shtetasi e humb shtetësinë me vendim të organit konkret për arsye se disa vite me radhë qëndronte jashtë shtetit të i cili është. Në sistemet juridike bashkëkohore mungimi nuk është mënyrë e cila është e pranuar përgjithësisht.<sup>51</sup> Lidhja juridike midis personit fizik dhe sovranitetit të shtetit konkret mund të pushoj në forma të ndryshme. Secili shtet në mënyrë sovranë përcakton mënyrat e humbjes së tij. Kur shtetasi humb shtetësinë në bazë të secilës do mënyrë të lartpërmendur atëherë ai trajtohet si i huaj dhe nuk mund të gëzojë të drejta absolutisht të rezervuara. Instituti i humbjes së shtetësisë krijon efekte juridike si ndaj shtetasit i cili ka humbur shtetësinë ashtu edhe ndaj anëtarëve të familjes së tij. Në disa shtete shtetësia humb karakterin me ligj kurse shtete tjera organi kompetent duhet të nxjerrë vendim për humbjen e shtetësisë. Efektet juridike të humbjes së shtetësisë ndaj anëtarëve të familjes së shtetasve që e humb shtetësinë dallohen në shtete të ndryshme.

---

<sup>51</sup> Asllan Bilalli, Hajredin Kuçi, E drejta ndërkombëtare private, Tetovë, 2008, fq.196

## **Rezultatet e hulumtimit –Analizat e fitimit të vendbanimit nëper vende të ndryshme në rajon**

Si rezultate te analizave te vendbanimit nëper vende të ndryshme ne rajn jane ato rezultate duke marur paraysh se vendbanimi është fakt vendimtar subsidiar për gëzimin (ushtrimin) e të drejtave të caktura civile nga të huajt ,për zbatimin e të drejtës së huajt ose të vendit dhe për caktimin e kompetencës së gjykatës së vendit ose të huaj te marrdhëniet statusore dhe marrëdhëniet statusore dhe mardhëniet trashëgimore me element të huaj. Vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar për caktimin e kompetencës së organit gjyqësor – në shtetet e emigracionit, vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar ka rëndësi më të madhe gjatë caktimit të kompetencës së gjykatës, respektivisht shtetet e emigracionit të cilat e zbatojnë shtetësinë si fakt vendimtar primar te mardhëniet statusore dhe trashëgimore me element të huaj,vendbanimi (domicili) shërben si fakt vendimtar subsidiar për caktimin e kompetencës së gjykatës në shumicën e këtyre shteteve kur shtrohet çështja e shkurorëzimit të martesave të përziera.

Gjithashtu, vendbanimi është fakt vendimtar në të drejtën ndërkombëtare procedurale sipas ligjit për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve, ku vjen në shprehje posaqërisht gjatë përcaktimit të kompetencës ekskluzive të gjykatës,te kontestet martesore.

Vendbanimi shërben si fakt vendimtar subsidiar për rregullimin e mardhënieve të njëjta të personave bipatridë apo apatridë.

Vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar për caktimin e të drejtës kompetente - paraqitet si fakt vendimtar subsidiar në disa raste (për caktimin e të drejtës kompetente) kur zgjidhja nuk mund të arrihet sipas ligjit të shtetësisë (lex nationalis).

Lidhur me këtë spektër ne mund të bazohemi edhe në Ligjin e të drejtës ndërkombëtare private, i cili në rastin tonë paraqitet si burim primar i rregullimit të kësaj materie, e cila ka një rëndësi shumë specifike lidhur me vendbanimin dhe me shtetësinë.

Sipas ligjit për DNP, vendbanimi si fakt vendimtar subsidiar paraqitet:

- 1. Për shumë lloje të kontratave**
- 2. Për efektet juridike të martesës**
- 3. Për efektet e bashkësisë jashtëmartesore**
- 4. . Për raportet prind fëmije**
- 5.Për efektet juridike të adoptimit .**

Refik Mustafa; vep. e cit., fq, 44, 45



## Konkluzioni

Në rastet kur flasim për vendbanimin dhe shtetësinë, në pjesën më lartë sqaruam lidhur me nocionin e vendbanimit dhe shtetësisë, rolin e tyre dhe funksionin e tyre që ka për subjektët e së drejtës.

Në këtë temë përmendëm vendbanimin si një fakt identifikimi në të cilën e bën më të lehtë një marrëdhënie të caktuar juridike, duke pasur parasysh faktin se ku gjendet subjekti që e lidh këtë marrëdhënie juridike, cilat janë të drejta dhe detyrimet e tij dhe sipas cilës të drejtë ai duhet të veprojë në atë raport, mirëpo pos kësaj vendbanimi paraqitet edhe si fakt vendimtar me të cilën këtu nënkuptohet që subjekti në momentin që lidh një marrëdhënie të caktuar juridike, kjo marrëdhënie nuk rregullohet vetëm me të drejtat nacionale të atij subjekti, por që rregullohet me norma të së drejtës ndërkombëtare. Pra, kur flasim për subjektët e rëndësishme është të dihet se bëhet fjalë për personat fizik dhe personat juridik.

Në këtë temë poashtu sqaruam rolin dhe funksionin e shtetësisë si një lidhje mjaftë specifike mes një personi të caktuar dhe shtetit të caktuar. Me këtë gjë nënkuptohet që kur një subjekt i takon një shteti të caktuar, atëherë atij i takojnë edhe të drejtat dhe detyrimet të cilat shteti ia garanton ato, ndërsa kur flasim për personat juridik, atëherë ato paraqiten me përkatësinë, më saktë thënë nacionalitetin e tyre. Shtetësia, luan një rol shumë të madhë lidhur me përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve, por njëkohësisht është një pjesë mjaftë specifike me të cilën bëhet rregullimi i marrëdhënieve të një subjekti të një shteti dhe një subjekti të një shteti tjetër.

Në këtë temë janë paraqitur në mënyrë mjaftë të qartë lidhur me rëndësinë e vendbanimit si një fakt identifikimi dhe fakt vendimtar si dhe për rolin dhe rëndësinë e shtetësisë lidhur me raportet të cilat mund t'i formojnë subjektet e caktuara.

## Rekomandime

- Ti jepet rëndësia e duhur vendbanimit, mbase paraqitet si fakt i identifikimit kur një subjekt lidh një marrëdhënie të caktuar me një subjekt tjetër
- Të merret parasysh vendbanimi, mbase paraqitet si fakt vendimtar lidhur me marrëdhënie e caktuar që mund të lidhet mes një subjekti të një shteti dhe subjektit të shtetit tjetër dhe në këtë rast ky raport rregullohet me normat e të drejtës ndërkombëtare
- Vendbanimi ka rëndësi të posaçme për të gjithë subjektët të cilët lidhin një marrëdhënie të caktuar juridike
- Shtetësia është bazamenti me të cilën një subjekt i caktuar gëzon të drejta dhe obligohet për detyrime ndaj një shteti të caktuar.
- Në kuadër të shtetësisë, personit fizik, në mënyrë direkte i bëhen të ditur se prej cilit shtet është dhe se si rregullohen të drejtat dhe detyrimet e tij.
- Kur flasim për personat juridik, shtetësia luan një rol mjaftë të rëndësishëm në rastet kur formohet një marrëdhënie e caktuar juridike mes një personi juridik të brendshëm dhe një person tjetër juridik

## Përfundimi

E kemi përmendur edhe më lart se vendbanimi si fakt identifikimi dhe fakt vendimtar konsiston në atë se personii cili merr pjesë në cilëndo qoftë marrëdhënie juridike private nuk është vendas i vendit që të konstatohet se marrëdhënie e tillë nuk rregullohet me norma të degëve tjera të sistemit juridike të vendit por rregullohet me norma të të drejtës ndërkombëtare. Vendbanimi si fakt identifikimi dhe fakt vendimtar është tërësi juridike që përcakton normat juridike të sistemit juridik të një vendit konkret që përcakton mënyrën e fitimit të saj. Sipas një qëndrimi vendbanimi është lidhje kontraktuese mes vendit dhe personit fizik në bazë të së cilës lidhje krijohen të drejtat dhe detyrimet reciproke këtë teori e përfaqëson edhe doktrina franceze me përfaqësuesin Andre Èeiss.

Kjo ka një rol shumë të rëndësishëm mbase vendbanimi sqarohet se në cilat raste paraqitet si fakt identifikimi, që kjo luan rol specifik sa i përket të drejtave të caktuara me atë subjekt dhe në cilat raste paraqitet si fakt vendimtar që njëashtu sqaron të drejtat dhe detyrimet lidhur me subjektin e caktuar. Për këtë shkak, tentuam që nëpërmjet këtij punimi të bëjmë sqarim të detajuar lidhur me atë se në cilat raste vendbanimi dhe shtetësia paraqitet si fakt i identifikimit dhe fakt vendimtar, kjo duke pasur parasysh rëndësinë e vendbanimit dhe shtetësisë për subjektet, qofshin ata persona fizik apo persona juridik.

## BIBLIOGRAFIA

- Asllan Bilalli; Hajredin Kuqi, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2013
- Balibar, É. Nous, citoyens d'Europe [engl. prijevod] Èe, the people of Europe : reflections on transnational citizenship. Princeton ; Oxford : Princeton University Press, cop. 2004
- Ćapeta, T. Osnove prava Europske unije : na temelju Lisabonskog ugovora : gradivo za cjeloživotno obrazovanje pravnika. 2. izmijenjeno i dopunjeno izd. Zagreb : Narodne novine, 2011
- Đerđa, D. Državljanstvo Europske unije // Matična publikac. Pravo i porezi. - 11 (2002), 12
- Grubiša, D. Lisabonski ugovor i europsko građanstvo // Politička misao. - ISSN 0032-3241. - 47 (2010), 4 ; faqja 185-209
- Ljubanović, B. Problematika državljanstva Europske unije // Pravni vjesnik. - ISSN 0352-5317. - 25 (2009), 1 ;
- Marilyn Achiron, Doracakt për Parlamentarët Nr.11-2005, Shtetësia dhe Pashtetësia,2005.
- Daniel Gutman, E drejta ndërkombëtarë private, përkthyer nga origjinali frëngjisht edmond Xhabija dhe Valbona Nano, Botimi i VI, 2009.
- Jo Shaq, Igor Štiks, Državljeni i državljanstvo posle Jugoslavije, Clio, Beograd, 2012.
- E drejta ndërkombetare private,Daniel Gutman (2009)
- Igor Štiks, Nations and Citizens in Yugoslavia and the Post-Yugoslav States- One Hundred Years of Citizenship, Bloomsbury Academic, London, 2015.
- Svetolik Đ. Jovanović, Državljanstvo Socijalističke Federativne Republike Jugoslavije, Beograd 1977
- Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut

- Kuçi – Bilalli, Zhvillimi historik, burimet dhe kodifiki i të drejtës ndërkombëtare private, 2007
- Beale, Conflict of Laws, London, 1935
- Eisner, B., Međunarodno privatno pravo, I, Zagreb, 1953
- David, R., The International Unification of Private Law, Tûbingen, 1971